

**Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian
Misioni në Kosovë**

Departamenti i të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit të së Drejtës

**KOSOVË
Raport mbi Qendrat për Punë Sociale**

shkurt 2003

FJALORTH

KEGjFDKG	Konventa mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave
QPS	Qendrat për punë sociale
KDF	Konventa mbi të drejtat e fëmijës
DMS	Departamenti i Mirëqenies Sociale
KEDNj	Konventa Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut
RFJ	Republika Federale e Jugosllavisë
LP RFJ	Ligji Penal i Republikës Federale të Jugosllavisë
LPP RFJ	Ligji i Procedurës Penale të Republikës Federale të Jugosllavisë
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migrim
LPK	Ligji Penal i Kosovës
LMMF	Ligji mbi Martesën dhe Marrëdhënjet Familjare
LPJ	Ligji i Procedurës Jokontestimore
LMS	Ligji mbi Mbrojtjen Sociale
Ministria	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
OMIK	Misioni i OSBE-së në Kosovë
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian
RKS të KB	Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
TPIU	Shërbimi për Hetimin e Trafikimit dhe Prostitucionit
Deklarata Universale	Deklarata Universale mbi të Drejtat e Njeriut
UNMIK	Misioni i Administratës së Përkohëshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Mandati i OSBE-së mbi të drejtat e njeriut implementohet përmes punës së Departamentit për të drejtat e njeriut dhe sundim të së drejtës¹, i cili si njërin prej prioriteteve programore e ka mandatin për të përcjellur (monitoruar) promovuar dhe ngritur vetëdijen për të drejtat e njeriut në Kosovë; përmes aktiviteteve vetanake të përqendruara në aspekte të specializuara, departamenti identifikon, vlerëson, paralajmëron autoritetet e duhuara, diskuton dhe bën të ditur për situatat e të drejtave të njeriut të cilat shfaqin shqetësime apo të cilat konsiderohen të nevojshme për t'ju përkushtuar theks të posaçëm.

Ky është raporti i parë shqyrtues i OSBE-së, mbi Qendrat për Punë Sociale (QPS-le), përkatësisht i realizuar nga Departamentit për të drejtat e njeriut dhe sundim të së drejtës – përmes, Sektorit për mbrojtje dhe përkrahje të viktimave (SMPV). Pas konfliktit në Kosovë gjatë vitit 1999 dhe themelimit të UNMIK-ut, shërbimet sociale si pjesë e administratës kishin rifilluar funksionimin. Në përgjithësi legjislacioni i mëparshëm së bashku me institucionet e themeluara në bazë të tij, vazhduan të ekzitojnë gjerësisht. Rregulloret e UNMIK-ut krijuan ndryshime strukturore dhe mundësuan krijimin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (Ministrinë) dhe Shëndetësisë. Disa prej institucioneve të themeluara në bazë të legjislacionit të mëparshëm, tani nuk ekzitojnë më në Kosovë.

Ministria është përgjegjëse për shërbimet sociale në Kosovë dhe kompetencat e saj janë zhvilluar përmes Departamentit të Mirëqenies Sociale (DMS-le), i cili bën koordinimin në nivelin veprues me komunata dhe format e ndryshme të bashkësive të themeluara më parë për mbrojtje sociale përfshirë këtu edhe QPS-le. QPS-le janë organet kryesore operative në nivelin komunal e të cilat ofrojnë ndihmë për personat e rrezikuar në shoqëri. Performanca e QPS-le ashtu siç është vëzhguar përmes përcjelljes së rasteve, ka ngritur shqetësime serioze mbi çështjet e ushtrimit të mandatit të tyre, njohurinë e obligimeve ligjore drejt qytetarëve të tyre dhe për të cilët ata mbajnë përgjegjësi. Njëra prej këtyre detyrave është që ato të ofrojnë një kornizë efektive legjislative në të cilën përfshihen të drejtat të cilat nuk mundësojnë (përmes dështimit) të rrisin shkallën e shkeljeve të të drejtave të njeriut. Edhpe shtete nuk mbahen drejtpërdrejtë të përgjegjshme për mosdhënjen efektive të shërbimeve sociale, megjithatë mosveprimi i tyre përmes mosmbrojtjes së të drejtave, psh, të drejtës në jetë familjare dhe për të mos përfjetuar torturë apo trajtim johuman dhe nënçmues, është kritikuar nga Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut.

Sa i përket fëmijëve, OSBE-ja ka vërejtur se QPS-le nuk i kanë përmbushë të gjitha përgjegjësitë brenda madatit të tyre dhe se njohuritë mbi këto obligime nuk kanë qenë të kompletuara, e që roli kryesor i QPS-le do të ishte përgatitja e fëmijëve për reintegrim në shoqëri. Problem në vehte ishte se, më shumë vëmendje i është kushtuar normave kulturore se sa obligimeve ligjore. Kjo kryesisht është vërejtur në rastet e besimit të fëmijëve apo konfliktet tjera familjare, me ç'rast nga QPS-le kërkohet që të marrin parasyshtë interesin më të mirë të fëmijës, por, në vend të kësaj, tendencat ishin drejt fokusimit në aspektet financiare të këtyre rasteve e jo aspektet më të gjëra rehabilituese apo psikologjike. Më tej, QPS-le dukej se nuk ishin të vetëdijshme mbi rolin e tyre që të veprojnë në cilësinë e kujdestarit prë të mbrojtur interesin më të mirë të fëmijës apo për të reaguar ndaj fëmijëve të lënë pas dore.

Sa i përket grave, QPS-le nuk duket se i kishin përmbushur obligimet e tyre për të siguruar se femrat i gëzojnë të drejtat të cilat u përkasin. Një shqetësim i veçantë ishte të siguruarit se legjislacioni në fuqi apo praktika relevante nuk është diskriminuese ndaj femrës në atë masë sa ato nuk do të mund t'i realizojnë të drejtat e tyre. Gjithashtu është përcjellur edhe praktika e aspekteve të shkurorëzimit, të besuarit e fëmijës nën kujdesje, pronës, me ç'rast janë shfrytëzuar kritere siç janë gjendja financiare, e që janë zbatuar në mënyrë diskriminuese. Aspektet tjera shqetësuese përfshijnë shërbimet sociale që i u jipen viktimave të dhunës familjare, dhunimit

¹ Mandati i OSBE-së në Kosovë sa i përket aspektit të të drejtave të njeriut dhe sundimit të së drejtës, buron nga Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të KB-ve nr. 1244 e cila thekson se, njëra prej detyrave primare të pranisë civile ndërkombëtare është "të promovojë dhe mbrojtë të drejtat e njeriut" (paragrafi 11(j)). Në raportin e Sekretarit të Përgjithshëm të datës 12 korrik 1999, roli udhëheqës mbi të drejtat e njeriut brenda UNMIK-ut, i është dhënë OSBE-së – Shtyllës së UNMIK-ut për ndërtimin e institucioneve - . Në paragrafin 87 të raportit të Sekretarit të Përgjithshëm thuhet "UNMIK-u do të ketë në dispozitim një numër monitoruesish dhe këshilltarësh të cilët do të kenë qasje të papenguar në të gjitha pjesët e Kosovës, për të hetuar shkeljet dhe për të siguruar se çështjet e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut të adresohen përmes strukturaeve të përgjithshme të misionit".

bashkëshortor dhe dhunimit seksual. Rastet e viktimave të trafikimit ishin aspekti tjetër në të cilin QPS-le nuk ishin të afta për t'i kryer obligimet e veta. Është konstatuar se QPS-le nuk kishin njohuri mbi obligimet e tyre të dhënjes së ndihmës për këto viktimë, dhe ju mungonte njohuria mbi ligjet dhe procedurat përkatëse.

Nën mandatin e tyre qëndron edhe obligimi i QPS-le që të veprojnë në emër të interesit më të mirë të personave të sëmurë mentalisht; megjithatë është konstatuar se QPS-le nuk ishin të vetëdijshme për obligimet e tyre të plota. Legjislacioni i tanishëm gjithashtu nuk ofron mbrojtje substanciale në të cilën janë të inkuorpuara standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Për t'i trajtuar këto zbarstësira në njohuri dhe hutinë ekzistuese në mesin e punëtorëve të QPS-le, lidhur me ligjin në fuqi, OSBE ka vërejtur nevojën për rishikimin e legjislacionit ekzistues dhe lëshimin e instruksioneve të qarta, dhe udhëzime përkatëse nga ana e Ministrisë dhe DPS-le, mbi çështjet praktike përfshirë këtu edhe përmirësimin e bashkëpunimit në mes të akterëve të ndryshëm shtetëror përmes një memorandumit të mirëkuptimit. Rishtazi OSBE është njoftuar mbi nismat e ndërmarra nga ana e Ministrisë dhe DMS-le për rishikimin e legjislacionit dhe për udhëzimin e punëtorëve social mbi politikën dhe praktikën më të reja në këtë lëmi. Megjithë se, këto nisma meritojnë lavdata, rezultatet e këtyre zhvillimeve të fundit nuk janë të dukshme në veprimtarinë themelore të QPS-le, dhe OSBE rekomandon ndërmarrjen e angazhimeve shtesë drejt sigurimit të një rishikimi të plotë të legjislacionit në fuqi dhe zbatimin e secilës reforme legjislative në mënyrë të drejtpërdrejtë në praktikën e punës së QPS-le. Do të rekomandohej një angazhim i shtuar i DPS-le dhe një mbikqyrje më e madhe ndaj QPS-le, përmes raportimeve të rregullta për të përmirësuar përgjegjshmërinë dhe rezultatet në përgjithësi të punës, përfshirë edhe menaxhimin e lëndëve. Staf i QPS-le duhet t'u jipet ndihmë e vazhdueshme në trajtimin e rasteve të komplikuar, por edhe përmes trajnimit mbi legjislacionin pozitiv, të ri dhe procedurat. Veprimet tjera duhet të ndërmerren gjithashtu për të mbrojtur konfidencialitetin dhe për të siguruar se stafi i QPS-le është i balancuar nga aspekti gjinor.

KONKLuzionet dhe Rekomandimet

Pas vëzhgimeve dhe analizës së rezultateve të Ministrisë dhe komponenteve të sajë në aspektin e mbrojtjes sociale, ky raport da dalur me këto konkluzione dhe rekomandime, në pikëpamje të ngritjes së kapaciteteve të organeve të mbrojtjes sociale që këto të fundit t'i përgjigjen në mënyrë efektive sfidave të paraqitura dhe të ballafaqohen me to.

I. ZHVILLIMI I KORNIZËS INSTITUCIONALE DHE ORGANIZATIVE

Si rezultat i ndryshimeve të vazhdueshme në strukturën institucionale të organeve të mbrojtjes sociale, ky raport identifikon mungesën e udhëzimeve dhe koordinimeve të QPS-le në pjesën qendrore të autoriteteve sociale (Ministri dhe DMS-le)

1. Kështu që rekomandohet që Ministria dhe DMS-le në mënyrë aktive të drejtojnë dhe mbikqyrin institucionet e mirëqenies sociale, posaçërisht aspektet si në vijim:
 - Përpilimin e instruksioneve dhe udhëzimeve të qarta për QPS-le mbi rolin e tyre të Institucionit të Kujdestarisë, dhe posaçërisht lidhur me rastet e fëmijëve dhe të sëmurëve mental.
 - Përpilimin e instruksioneve mbi përzgjedhjen dhe kërkesat për kujdesatë ligjor dhe rregullimin e sistemit vlerësues për këta të fundit dhe kujdesëdhënsit.
 - Zhvillimin e mëtutjeshëm të shtëpive të sigurta (strehimoreve) përgjatë Kosovës, për kategori të ndryshme të personave të rrezikuar e veçanërisht për gra dhe fëmijë.
 - Përmirësimin e programeve rehabilituese për grupe sociale të rrezikuara, përfshirë dhënjen e këshillave, arsimimin dhe ndihmën drejt resocializimit.
 - Së bashku me Institutione të Mbrojtjes Sociale (IMS) hartimi i politikës mbi rolin e IQPS-le në asistimin e viktimave të trafikimit.

- Duhet rivendosur praktikën e nxjerrjes statuteve komunale për të ofruar udhëzime mbi fokusimin e punës së QPS-le nëpër komunat përkatëse, pasi që këto statute janë dëshmuar si efikase në identifikimin e gjendjeve specifike sociale në komunë dhe pastaj, të formësohen mekanizma adekutatë për t'i trajtuar ato situata².
- 2. Roli dhe funksioni institucional i IMS-le duhet të rishikohet duke pasur parasysh se kjo mund të ofrojë një pasqyrë relevante dhe kërkimore mbi çështjet e përgjithshme të shërbimeve sociale për Ministrinë dhe DMS-le. Në veçanti IMS-le duhet të koncentrohet në pozitën e grave në Kosovë, çështjet e diskriminimit në sferën publike, dhunën familjare, dhe duhet të bëjë rekomandime mbi aspektet e sipërpërmendura. Gjithashtu mund të merrë rolin udhëheqës në koordinimin e përpjekjeve dhe iniciativave të organve relevante dhe organizatave tjera të interesuara, drejt identifikimit dhe hartimit të politikave dhe strategjive të reja të mbrojtjes sociale.
- 3. Ekziston nevoja për një bashkëpunim dhe koordinim më të mirë në mes të policisë, personelit mjekësor dhe gjykatave në njërin anë dhe organeve të mbrojtjes sociale dhe OJQ-ve vendëse dhe ndërkombëtare në anën tjetër për t'u fokusuar në nevojat e viktimës. Ministria dhe DMS-le duhet të fokusohen në identifikimin e organizatave të ndryshme dhe të marrin pjesë në memorandumun për mirëkuptim, me ç'rast definohej qartë obligimet e palëve relevante dhe mekanizmat e llogaridhënjes, në rast të dështimit për t'ju përmbajtur obligimeve. Një vëmendje e veçantë duhet t'i përkushtohet hyrjes në memorandumun për mirëkuptim me gjykatat dhe organet për zbatimin e ligjit (UNMIK, shtylla I).
- 4. Përzgjedhja e të punësuarave në QPS-le nuk është e balancuar në mënyrë të mjaftueshme për nga aspekti gjinor, dhe kjo ndikon në cilësinë e shërbimeve në disponim për viktimat e veçanërisht atyre femra dhe personat e trafikuar. Rekomandimi bëhet në atë drejtim që të sigurohet se bilanci gjinor është adresuar si në nivelin e punëtorëve të lëndëve e deri te niveli i drejtorëve. Gjithashtu duhet të ketë caktim të punëtorëve të cilët punojnë në lëndë të caktuara, me trafikim, dhunë familjare, të sëmurë mentalisht dhe mbrojtje të fëmijëve.

II. ZHVILLIMI I KORNIZËS LEGJILATIVE

Analiza e ligjit në fuqi mbi mbrojtjen sociale dhe problemet të cilat dalin nga rastet për studim të dokumentuara me këtë raport, kanë vënë në pah nevojën e një rishikimi të përgjithshëm të legjislacionit në fushën e shërbimeve sociale. Rishikimi i tillë do të duhej të kryhej nga grupi punues i përbërë nga autoritetet relevante (MPMS-le dhe DMS-le) dhe OJQ-të e interesuara vendëse dhe ndërkombëtare, nën autoritetin e IMS-le si një organ nga i cili supozohet të nxjerrë politika të përgjithshme dhe të kryej kërkime relevante në lëmin e mbrojtjes sociale.

- 5. Ky rishikim duhet të identifikojë çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen sociale e që nuk janë të mbuluara me ligjin në fuqi, dhe aspektet legjislative të cilat nuk janë të qarta në mënyrë të mjaftueshme apo ju mungon zbatueshmëria/implementimi i plotë dhe mekanizmat përkatës. Pas rishikimit, nga grupi punues do të pritej që ata të paraqesin propozime të reja për t'u adresuar zbrastësirat ligjore në lëmin e mbrojtjes sociale. Aty ku ekziston legjislacioni, por zbatimi i tij identifikohet si problematik, atëherë duhet sugjeruar procedura dhe mekanizma më të fuqishëm, qoftë përmes legjislacionit të ri të miratuar në Kuvend apo përmes qarkoreve të interne por me standarde ndërkombëtare, dhe në veçanti kur është fjala për shëndetësinë mentale dhe dhunën familjare.
- 6. Kodi i tanishëm i sjelljes profesionale për QPS-le (miratuar në dhjetor 2002) duhet të ndryshojë për të përbërë meknizmat efikas dhe të zbatueshëm dicitlinorë kundër punëtorëve social apo të punësuarve tjerë të cilët shkelin rregullat e sjelljes apo konfidencialitetin. Më tej, duhet zgjidhur me urgjencë çështja e mungesës së dhomave të ndara për intervistimin e klientëve nëpër disa QPS-le gjë që në mënyrë direkte ndikon në natyrën konfidenciale të ndihmës sociale.

III. TRAJNIMI DHE VETËDIJËSIMI

Në QPS-le është vërejtur mungesa e njohjes së legjislacionit relevant, procedurave dhe rolit të tyre për grupe të ndryshme sociale.

² Lexo fusnotën 14 (sqarime mbi statutet komunale në aspektin e mbrojtjes sociale.

7. Për QPS-le rekomandohet trajnim në këto lëmi:

- Mbi pozitën e viktimave të trafikimit sipas ligjit në fuqi, standardeve ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut dhe rregullores së UNMIK-ut 2001/4; roli i ekzakt i QPS-le ndaj viktimave të trafikimit dhe përmbajtja e “ndihmës sociale” në kuptim të rregullores së UNMIK-ut nr 2001/4.
- Mbi masat ligjore në disponim për t’ju ndihmuar viktimave të dhunës familjare sipas ligjit vendës dhe standardeve ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut.
- Detyrat dhe përgjegjësitë e QPS-le në pajtim me ligjin vendës dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në dhënjen e ndihës direkte personave të sëmurë mentalisht, duhet të përcaktohen më qartë.
- Mbi përdorimin e pajtimit në çështjet e ndërlidhura me konfliktet familjare.
- Aplikimin e kriterëve të tilla sikur që janë rastet për vendosjen mbi besimin e fëmijës nën kujdestari (psh, kriteri ekonomik) në mënyrë jodiskriminuese.

8. Ministrisë dhe komponenteve të sajë i rekomandohet të iniciojnë një fushatë publike të vetëdijësimit e cila do të kishte në fokus shfrytëzimin seksual/dhunën, dhunën familjare, neglizhencën familjare, të sëmurët mental dhe çështjet tjera me ndikim në opinionin e shoqërisë mbi pozitën e këtyre grupeve sociale të rrezikuara.

IV. RESURSET

OSBE është e vetëdijshme për mungesën e resurseve në QPS-le, sidoçoftë, ky raport nuk ka për qëllim vlerësimin e resurseve të nevojshme për autoritetet e mbrojtjes sociale për të përmirësuar rezultatet e tyre të gjithëmbarrshme dhe përgjigjen e tyre ndaj rasteve sociale. Megjithatë, janë disa aspekte të punës së QPS-le të cilat obligojnë për alokim të menjëhershëm të resurseve.

9. Ministria dhe DMS-le duhet të përqendrojnë angazhimet e tyre në rekrutimin e psikologëve të kualifikuar, të cilët ose janë të specializuar në llojin e traumës e cila zakonisht shfaqet te grupet sociale të cilat ndihmohen nga QPS-le, apo janë të specializuar në lëmi të ndryshme siç janë psikologët e specializuar në çështjet e fëmijëve, dhunën familjare, trafikim, të sëmurë mental etj.
10. Për të përmirësuar efikasitetin e QPS-le duhet të adresohet mungesa e tanishme e pajisjeve në zyre sikur që janë kompjutorët dhe automjetet, përfshirë këtu edhe sistematizimin efikas të dosjeve dhe sistemin e arkivimit.
11. Rekomandohet përmirësimi i menaxhimit të rasteve (lëndëve), si një mjet për të adresuar natyrën ad-hok të përgjigjes së QPS-le ndaj rasteve të dhunës familjare dhe lënjës pas dore dhe abuzimit të fëmijëve. Rekomandohet që rastet të rangohen sipas prioriteteve dhe nivelit të urgjencës, dhe t’i kushtohet kujdes i posaçëm rasteve problematike të cilat janë proces e sipër e posaçërisht atyre në të cilat janë involvuar fëmijët dhe viktimat e dhunës seksuale. Për organizimin e kësaj që u tha, nevojitet një numër i mjaftueshëm i personelit të trajnuar dhe të involvuar në çështje të ndryshme, dhe të cilët i përcjellin rastet të cilat iu ndahen atyre në mënyrë konsistente.

SHTRIRJA E RAPORTIT

Raporti i tanishëm do të ndriçojë problemet me të cilat përballen QPS-le si dhe sfidat e shtuara në dhënjen e ndihmës dhe mbrojtjes adekuate për ato kategori të viktimave apo personave të rrezikuar, mirëqenia dhe përkujdesi ndaj të cilëve sipas ligjit në fuqi në Kosovë, bie nën kompetencën ekskluzive të autoriteteve të mbrojtjes sociale³.

QPS-le kanë për detyrë të ofrojnë shërbime profesionale të mbrojtjes sociale dhe të ushtrojnë autoritetin e tyre i cili buron nga ligji mbi mbrojtjen sociale dhe nga legjet tjera relevante siç është, ligji vendës mbi familjen.⁴ Gjithashtu, edhe instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të dedikuara për mbrojtjen e viktimave të

³ OSBE është pajtuar të nxjerrë raportin, pas mbledhjes së mbajtur me Departamentin e shërbimeve sociale me 4 korrik 2002

⁴ Neni 12 në lidhje me nenin 38 të LMS-le.

krimit, grave dhe fëmijëve, janë pjesë përbërëse e vlerësimit të mënyrës sipas të cilës QPS-le i kanë kryer obligimet e tyre ligjore.

Sipas statistikave të siguruara nga DMS-le, për periudhën kohore prej dhjetorit 2001 deri në nëntor 2002, QPS-le kanë punuar në mbi 3.903 lëndë, nga të cilat 203 lëndë të dhunës familjare, 2.834 lëndë që kishin të bënin me mbrojtjen e fëmijës,⁵ 34 raste të viktimave femra të trafikimit me njerëz dhe 832 raste që kishin të bënin me të sëmurë mental.⁶

Ky raport do të përqendrohet në rastet të cilat kanë të bëjnë me fëmijët viktimë të abuzimit apo lënjes pas dore, femrat viktimë të dhunës familjare, personat e trafikuar dhe personat e sëmurë mentalisht. Ky raport do të diskutojë punën dhe angazhimin e QPS-le në rastet e tilla dhe njëkohësisht do të adresojë problemet praktike dhe kompatibilitetin e detyrave të tyre me ligjin në fuqi në Kosovë, përfshirë këtu edhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Analizat dhe argumentet e këtij raporti bazohen në shënimet dhe të dhënat faktike të mbledhura gjatë periudhës raportuese të monitorueseve të OSBE-së në terren. Këta monitorues kanë mbledhur informata gjatë monitorimit të rasteve relevante por edhe përmes komunikimit me QPS-le dhe DMS-le në Pejë, Prizren, Prishtinë, Mitrovicë dhe Gjiilan. SMPV ka monitoruar 38 raste ku fëmijët ishin të involvuar, 12 raste ku ishin të përfshira femrat dhe 7 raste të trafikimit⁷.

MANDATI I SEKSIONIT PËR MBROJTJEN DHE PÛRKRAHJEN E VIKTIMAVE (SMPV)

SMPV dhe qasja e tij e specializuar mbi viktimat e krimit në përgjithësi, dhe në veçanti për viktimat e dhunës seksuale dhe familjare, ka evoluar nga aktivitetet e përgjithësuara të departamentit në fushën e mbrojtjes dhe përkrahjes së viktimave dhe ka qenë i pranishëm që nga muaji maj i vitit 2001, përkrah interesave dhe përkrahjes së shtuar të OSBE-së në punët dhe strategjitë kundër trafikimit. Duke u bazuar në mandatin që e ka, SMPV përqendrohet në:

- ◆ Krijimin e një kornize të gjërë të drejtash për viktimat, e cila përfshinë qasjen e shtuar në të gjithë mekanizmat e drejtësisë në shërbim për viktimat, dhe krijimin e një përgjigjëje adekuate qeveritare për personat nën rrezik të viktimizimit;
- ◆ Monitorim dhe raportim, dhënje të ndihmës së drejtpërdrejtë, ndërlidhje dhe koordinim në mes të sektorëve qeveritarë dhe joqeveritarë të angazhuar në çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe përkrahjen e viktimave, por edhe kryerjen e analizave dhe krijimin e politikave;
- ◆ Përgjigjet ndaj dhunës së bazuar në gjini dhe viktimave të trafikimit, dhe ndaj strukturave përkatëse, si dhe mekanizmave përkatës për mbrojtjen e fëmijës, me një vetëdijësim më të lartë për nevojat e viktimave tjera të rrezikueshmërisë së lartë, siç janë ato me paaftësi mendore, të moshuarit dhe pakicat.

Mbrojtja e viktimave dhe parandalimi i viktimizimit përmes mekanizmave ligjorë, paraqet vetëm një pjesë të punës të cilën e kryen SMPV. Gjatë ndihmës së dhënë në përgatitjen e projektit të Kodit Penal dhe të Procedurës Penale, SMPV ka ofruar këshilla mbi aspektet specifike të cilat kishin nevojë për t'u zhvilluar, e posaçërisht veprat penale të dhunës së bazuar në gjini. SMPV ka punuar drejt sigurimit të mbrojtjes juridike për viktimat dhe për një rol të institucionalizuar të mekanizmave mbrojtës (avokues) për viktimat. E gjithë kjo, në koordinim me hartuesit e Kodit të Procedurës Penale për të ofruar bazën juridike për sistemin mbrojtës (avokues) për viktimat. SMPV gjithashtu ka luajtur një rol të madhë në hartimin e rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/4, mbi ndalimin e trafikimit me njerëz në Kosovë.

Në angazhimin në çështjet e dhunës familjare, SMPV kryeson grupin punues i cili përfshinë OJQ-re dhe organizmat relevant të UNMIK-ut dhe KB-ra, grup ky i cili ka hartuar rregulloren e UNMIK-ut mbi udhërat mbrojtës për viktimat e dhunës familjare. SMPV gjithashtu është angazhuar në grupin punues për avokimin e çështjes së emërimit formal të gjykatësve familjarë dhe trajnimit të tyre të specializuar në gjykata. Më tutje,

⁵ Përfshirë fëmijët jetima, të braktisur, të varfër, që jetojnë në familjet abuzive, pa kujdestar ligjor, delikuentët dhe ata me zhvillim psikosocial të çrregulluar. Shumica e rasteve me të cilat janë marrë QPS-le për mbrojtjen e fëmijëve, kanë të bëjnë me delikuentët e të miturve.

⁶ Këto shifra nuk mbulojnë komunën e Prishtinës dhe Prizrenit.

⁷ Rasetet e personave të sëmurë mentalisht ishin monitoruar atëherë kur ato janë ngitur në kontekst të rasteve me fëmijë dhe gra.

SMPV ka marrë pjesë në procesin e shqyrtimit të ligjeve pozitive mbi familjen dhe mirëqenien sociale, që është zhvilluar brenda departamentit, përkatësisht, ka rekomanduar reformimin e ligjeve dhe politikave përkatëse.

Në kuadër të shqetësimeve të vazhdueshme të tij për viktimat e dhunës seksuale, dhe si përgjigje ndaj autoriteteve relevante, të nivelit qendror edhe atyre komunale, SMPV ka punuar me partnerët ndërkombëtarë për konstituimin e protokoleve standarde për trajtimin e këtyre viktimave, si nga ana e organeve për zbatimin e ligjit poashtu edhe nga autoritetet shëndetësore. SMPV përqendrohet gjithashtu edhe në identifikimin dhe krijimin e skemës për dhënjën e ndihmës dhe përkrahjes për viktimat e krimit dhe grupeve tjera të rrezikuara, duke përfshirë këtu edhe krijimin e rrjetit referues në shërbim të tyre.

Gjatë shqyrtimit të disa problemeve praktike në fushën e mbrojtjes (avokimit) dhe përkrahjes për viktimat, OSBE është duke shfrytëzuar kontributin vullnetarë të dhënë nga Shtetet e Bashkuara në luftimin e dhunës familjare, duke ju dhënë secilës QPS-le, 31 sosh në Kosovë, nga një telefon mobil dhe kartela mbushëse, për të siguruar sistemin e “telefonit kujdestarë”, si një parakusht për sistemin referues funksional për viktimat e krimit. Këto mjete janë alokuar gjithashtu edhe për krijimin e një posti të ri një-vjeçar “Këshilltarë vendës për çështjet e dhunës familjare” brenda Departamentit të Mirëqenies Sociale (DMS) në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (Ministrisë). Këto masa kanë për qëllim ngritjen e kapaciteteve për QPS-le që ato të ofrojnë shërbime cilësore të përkujdesjes dhe që në mënyrë adekuate t’ju përgjigjen nevojave të viktimave për asistencë.

Më tej, SMPV ka vënë një theks të veçantë në adresimin e nevojave imediate për strehimoret dhe shtëpitë e sigurta përgjatë Kosovës, për të mundësuar që viktimat me një rrezikueshmëri të lartë, të mundë t’i ikin dhunës. Për këtë arsye, disa prej mjeteve të sipërpërmedura janë alokuar për të mbështetur një strehimore të re e cila udhëhiqet nga një OJQ vendëse, dhe posaçërisht për viktimat e trafikimit. Si pjesë e programit gjithëpërfshirës të luftimit të trafikimit, SMPV bashkëpunon ngushtë me partnerët tjerë, siç janë, Oranizata Ndërkombëtare për Migrim (ONM) dhe Shërbimi për hetimin e trafikimit dhe prostitucionit në kuadër të policisë së UNMIK-ut.

PJESA 1: SFONDI I LIGJIT NË FUQI DHE KORNIZËS INSTITUCIONALE

I. SFONDI HISTORIK

Nga perspektiva historike, ligji në fuqi i cili rregullonte institucionet e mbrojtjes sociale në Kosovë, si dhe funksionet e tyre, kishte hyrë në fuqi fillimisht nga Kushtetutat e viteve 1971 dhe 1974, gjatë periudhës së decentralizimit të strukturave organizative të “vetëqeverisjes socialiste”.⁸ Me ligj rreullohej krijimi, financimi dhe obligimet e “bashkësive vetëqeverisëse të interesi për mbrojtjes sociale” të cilat formoheshin përmes “marrëveshjeve vetëqeverisëse” dhe rregulloheshin me “statut”.⁹ Funksionet dhe obligimet themelore të këtyre organizatave për mbrojtje sociale rregulloheshin me ligj, ndërsa institucionet tjera “vetëqeverisëse” mund të krijoheshin edhe nga qytetarët dhe punëtorët në bazë të “vullnetit të tyre të lirë”. Ligji parashikoi ekzistimin e QPS-le si një prej formave primare të bashkësive (BVI-ve) për mbrojtje sociale.¹⁰ Detyrat kryesore dhe procedurat të cilat rregullojnë punët dhe përgjegjësitë e QPS-le, parashihen me Ligjin për Mbrojtje Sociale¹¹ (LMS), Ligjin mbi Martesën dhe Marrëdhëniet Familjare¹² (LMMF), Ligjin e Procedurës Jokontestimore¹³ (LPJ) dhe në statutet komunale të QPS-le.¹⁴ LMS përcakton parimet e përgjithshme të mbrojtjes sociale dhe gjithashtu strukturën themelore të punës dhe veprimtarive të QPS-le. LMMF ka definuar kuptimin e shprehjes “përkujdesje sociale” dhe përcakton procedurat për rregullimin e familjes, martesës dhe çështjet e mbrojtjes së

⁸ Lexo shtojcën I për listën e ligjeve në fuqi.

⁹ Nenet 9 dhe 17 të Ligjit mbi BVI-të e Mbrojtjes Sociale.

¹⁰ Lexo nenet 45-58 LMS. Këto përfshijnë edhe BVI-të për punësim dhe kualifikim profesional.

¹¹ Ligji i Mbrojtjes Sociale, ka hyrë në fuqi me 29 mars 1976.

¹² Ligji mbi Martesën dhe Marrëdhëniet Familjare, ka hyrë në fuqi me 24 shkurt 1984.

¹³ Ligji mbi Procedurën Jokontestimore, ka hyrë në fuqi me 22 tetor 1986.

¹⁴ QPS-le më heret rregulloheshin me statute (neni 65 i LMS), të cilat miratoheshin me vendimin e këshillit ekzekutiv të QPS-le dhe Kuvendeve Komunale. Këto statute përcaktonte strukturën organizative, beneficionet, detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e QPS-le. Momentalisht, QPS-le veprojnë jashtë statuteve pasi që këto të fundit janë hequr nga përdorimi në Kosovë, kur ishte rënë administrata e mëparshme.

fëmijëve, përfshirë edhe rolin e Institucionit të Kujdestarisë (IK).¹⁵ LPJ-re përcakton procedurat gjyqësore gjatë vendosjes për çështjet personale, familjare apo pronësore.¹⁶

Ligji i sipërpërmendur mbi institucionet “vetëqeverisëse”, kishte themeluar edhe Kuvendin Krahinor të Mbrojtjes Sociale (KKMS) i cili ishte organ qendror dhe kishte atributet e hartimit të politikës së përgjithshme dhe për krijimin e strategjive.¹⁷ Përgjegjësia e këtij organi ishte që të formulojë politikën e përgjithshme të mbrojtjes sociale, dhe të krijojë programe për jetësimin e tyre duke u bazuar në hulumtimin e çështjeve sociale. Në veçanti, ky organ kishte për detyrë të sigurojë mbrojtje sociale për njerëzit që vuanin nga sëmundjet e rënda mentale dhe për fëmijët, dhe ishte përgjegjës për zhvillimin, reformimin dhe organizimin e shoqatave (BVI-ve) të mbrojtjes sociale në Kosovë.¹⁸ Në instancat komunale, Kuvendi i Bashkësive (BVI-ve) Komunale të mbrojtjes sociale (KBKMS) përcaktonte zhvillimin e politikës së mbrojtjes sociale në pajtim me nevojat e bashkësisë dhe zhvillonte skemat për realizimin e të drejtës në mbrojtje sociale.¹⁹

Në paraqitjen e tanishme të kornizës juridike të Kosovës, atributet e QPS-le nuk kanë ndryshuar në masë të konsiderueshme, për shkak se ligjet relevante të vendit dhe të cilat merren me mbrojtjen sociale, kanë mbetur krejtësisht të njëjta. Mirëpo, e gjithë struktura ekzekutive ka ndryshuar me ministrinë e cila është përgjegjëse për çështjet që kanë të bëjnë me mirëqenien sociale në Kosovë.²⁰ Shtojca VII e rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 përcakton detyrat e ministrisë, dhe të cilat përfshijnë, zhvillimin e politikave të punës dhe të mirëqenies sociale; implementimin e legjislacionit të këtyre aspekteve; promovimin e politikave dhe praktikave të mbrojtjes së familjes dhe personave të mitur; udhëzimin dhe mbikqyrjen e institucioneve të mirëqenies sociale në bashkëpunim me komunat, zyrat për punë sociale dhe institucionet tjera, si dhe dhënjen e ndihmës financiare. Para Ministrisë, Departamenti i shëndetësisë dhe mirëqenies sociale (DSHMS-le) i cili ekzistonte nën strukturën e përbashkët administrative, ishte përgjegjës për menaxhimin e përgjithshëm të çështjeve që kishin të bënin me shëndetësi dhe mirëqenie sociale në Kosovë.²¹ Pas shpalljes së Kornizës Kushtetuese, Ministria është themeluar së bashku me departamentet siç është DMS-le dhe Departamenti i Punës. Ministria në tërësi e zëvendësoi DASHMS-le dhe kishte marrë përsipër përgjegjësitë për çështjet e punës dhe mirëqenies sociale ndërsa çështjet e shëndetësisë u bartën në Ministrinë e Shëndetësisë. Sipas strukturës së tanishme, Ministria e ushtrimit autoritetin e vet qendror mbi politikat sociale përdorisa DMS-le bartë përgjegjësitë mbi strukturat komunale përfshirë edhe veprimtaritë e organeve të mbrojtjes sociale siç janë QPS-le.

Në bazë të kësaj, theksi i këtij raporti është që të vlerësojë rezultatet (performancën) e Ministrisë dhe komponenteve të saj, në dhënjen shërbimeve efikase të mirëqenies sociale në përputhje me obligimet pozitive që rrjedhin nga ligji vendës dhe ai ndërkombëtarë.

II. VLERËSIMI SIPAS LIGJIT VENDËS

Nga perspektiva e ligjit vendës në fuqi, të tri pjesët e sipërpërmendura të legjislacionit (LMS, LMMF dhe LPJ) vazhdojnë t'i rregullojnë parimet e mbrojtjes sociale si dhe strukturën themelore dhe përgjegjësitë për shërbimet e mbrojtjes sociale.

Sipas LMS, QPS-le janë përgjegjëse për ndërmarrjen e veprimeve në realizimin e mbrojtjes sociale,²² duke pasur parasysh nevojat e shoqërisë.²³ Ligji definon kategoritë specifike të personave për të cilët QPS-le duhet të ofrojnë mbrojtje sociale, përfshirë këtu edhe personat nevojtarë si term gjithëpërfshirës.²⁴ QPS-le gjithashtu janë

¹⁵ Neni 1 of the LMMF.

¹⁶ Neni 1 i LPJ.

¹⁷ KKMS është themeluar në pajtim me Ligjin për BVI-të për Mbrojtje Sociale, dhe puna e tij rregullohet me statutin e KKMS. Anëtarë të Kuvendit Krahinor janë Kuvendet Komunale të MS-le dhe për këtë KKMS përfaqëson institucionin i cili e bashkon punën e të gjitha Kuvendeve Komunale të MS-le. (neni 3 i Statuti të KKMS, 1976).

¹⁸ Nenet 3 dhe 15 të Statutit të of KKMS dhe neni 8 i Ligjit mbi BVI-të e Mbrojtjes Sociale.

¹⁹ Neni 7 i Ligjit mbi BVI-të e MS-le dhe neni 38 i LMS-le.

²⁰ Themeluar sipas rregullores së UNMIK-it nr 2001/19 mbi degën e ekzekutivit për organet e përkohëshme të vetëqeverisjes në Kosovë.

²¹ Themeluar në pajtim me rregulloren e UNMIK-ut nr 2000/10, mbi themelimin e Departamentit Administrativ të shëndetësisë dhe mirëqenies sociale

²² Neni 12 i LMS-le.

²³ Neni 7 i LMS-le.

²⁴ Shfrytëzuesi e mbrojtjes sociale të cilët në bazë të arsyeve dhe pozitës së tyre sociale janë veçanërisht: a) fëmijët; të cilët nuk kanë kujdes prindorë; të cilët kanë pësuar çrregullime në zhvillimin e tyre fizik dhe psikologjik; nga aspekti edukativ të lënë pas dore dhe zhvillimi i të cilëve pengohet për shkak të

përgjegjëse për përcjelljen e rasteve lëmin e mbrojtjes sociale, por edhe për t'u angazhuar në masat parandaluese dhe bashkëpunim me organizatat terjat të mbrojtjes sociale.²⁵ Para vitit 1999, QPS-le kanë qenë nën mbikqyrje të Institutit për Politikë Sociale (IPS)²⁶, mbikqyrje kjo e cila ka ndodhur çdo dy vjet. IPS-le i krijuar në instancë qendrore është një organizatë për hulumtime dhe zhvillim të politikave, përfshirë këtu zhvillimin e politikës sociale (neni 58 i LMS).²⁷

IK-së apo instituti i kujdestarisë ligjore buron nga LMMF dhe në shumicën e rasteve bie nën përgjegjësinë e QPS-le. Mbrojtja dhe ndihma sociale për familjet është përgjegjësi e organit komunal kompetent për mbrojtjen sociale, përveq nëse kuvendi komunal nuk vendosë për caktimin e organit tjetër të veprorë në cilësinë e IK-së.²⁸ IK-së ka përgjegjësi speciale për fëmijët pa kujdes prindor por edhe për personat të cilëve iu është hjekur me vendim gjyqësor, zotësia juridike për të vepruar.²⁹ Kjo përgjegjësi shtrihet në të gjitha kategoritë e nenit 14 të LMS-le. Krahas dhënjes së ndihmës sociale për njerëzit e Kosovës, IK-së ka përgjegjësinë edhe për t'ju ndihmuar shtetasve të huaj të cilët kanë nevojë për mbrojtje sociale.³⁰ Përgjegjësitë ndaj shtetasve të huaj përfundojnë vetëm atëherë kur autoritetet përkatëse të shtetit të personit në fjalë ndërmarrin veprime në emër të shtetasit të vetë.

Në bazë të LPJK-së, procedura jokontestimore mund të inicohet edhe nga personi privat, përfaqësuesi i tij ligjor apo sipas propozimit të organit të caktuar me ligj. Gjatë zgjidhjes së rasteve në të cilat dëgjohen fëmijët, gjykata *ex officio* ndërmerr masa speciale për të mbrojtur të drejtat dhe interesat ligjore të fëmijut i cili nuk gëzon kujdesin prindor apo personit i cili nuk mund të kujdeset për veten. IK-së edhepse me ligj është i autorizuar të inicojë procedurën gjyqësore,³¹ mund të ndërmerrë të gjitha masat e duhura para fillimit të procesit, përfshirë këtu edhe dhënjen e fakteve dhe kërkimin për mjetet juridike për fëmijët dhe personat të cilët kanë nevojë për mbrojtje sociale. Sipas Ligjit të Procedurës Jokontestimore, gjykatat mund të hjekin (revokojnë) tërësisht apo pjesërisht zotësinë juridike të personit. Kjo procedurë kryhet në bazë të prezentimit të fakteve nga ana e prindit, fëmijës apo të afërmeve tjerë, apo nga organi i cili vepron sipas “detyrës zyrtare dhe në bazë të kërkesës së Institucionit të Kujdestarisë”³². Sipas LPJ-re, institucionet shëndetësore janë përgjegjëse për informimin e gjykatave të vendosura në komunën e tyre dhe brenda 3 ditëve pas pranimit të personit të sëmurë mentalisht për shërim. Kjo posaçërisht ka të bëjë me rastet e personave/pacientëve të paaftë, apo pjesërisht të paaftë për të gjykuar dhe të japin pajtimin e tyre për shërim mjekësor.³³

III. VLERËSIMI I SIPAS TË DREJTËS NDËRKOMBËTARE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Ky raport ngrit shqetësime të ndryshme sa i përket detyrimeve të autoriteteve për mbrojtje sociale, në bazë të të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, veçanërisht në pajtim me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj). Dispozitat më të rëndësishme përkritazi me QPS-në janë drejta për respektimin e familjes dhe jetës private (neni 8), ndalimi i troturës (neni 3) dhe e drejta në mjete juridike efikase (neni 13).

Sipas KEDNj, ankesa e bazuar në nenin 3 mund të ngërthehet edhe me çështjet nga neni 8, posaçërisht në ndërlidhje me të drejtën për respektimin e familjes dhe jetës private. Në këto raste, qasja e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Gjykata Evropiane), ka qenë në balansimin e çështjes së kontrollimit të autoritetit shtetëror për të mos ndërhyrë në raportet ndërpersonale në njërën anë dhe në anën tjetër mbrojtjen e personave prej lëndimeve nga të tjerët.³⁴ Janë bërë interpretime të shumta sa i përket detyrimit të shtetit për të respektuar jetën familjare duke u bazuar në vrotimet e Gjykatës Evropiane në rastin *Marckx kundër Belgjikës* i cili thotë se neni 8 (1) jo vetëm që parandalon shtetin për të ndërhyrë në jetën familjare të dikujt mirëpo gjithashtu vendos

rethanave familjare. (b) Personat madhorë: materialisht të pambrojtur; tërësisht të paaftë për punë; personat e moshuar; invalidët; me sjellje të dëmshme shoqërore. (c) Personat tjerë që kanë nevojë për ndihmë sociale për aryera tjera.

²⁵ Neni 44 i LMS-le.

²⁶ Nenet 69 dhe 70 të LMS-le.

²⁷ Neni 3 i Statutit të Institutit për Politikë Sociale në Prishtinë.

²⁸ Neni 22 i LMMF.

²⁹ Neni 251 dhe 260 i LMMF.

³⁰ Neni 269 i LMMF.

³¹ Neni 4 i LPJ-re.

³² Neni 32 dhe 33 i LPJ-re.

³³ Neni 46 i LPJ-re.

³⁴ *Marckx kundër Belgjikës* A31(1979) dhe *X dhe Y kundër Holandës* A91 (1985)

detyrime mbi shtetin që të respektojë të drejtën për jetë familjare. Komisioni Evropian kishte interpretuar këtë deklaratë në mënyrë mjaft të gjerë dhe në një rast ajo thotë: “ Në formësimin e jetës familjare, shteti duhet të veprojë në mënyrë e cila do t'i mundësojë personat përkatës të çojnë jetë normale familjare... Komisioni mendon se kjo konsideratë vlen jo vetëm për legjislacionin i cili rregullon marrëdhëniet familjare, mirëpo gjithashtu edhe për legjislacionin i cili rregullon çështjet që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e pronës dhe në të njëjtën kohë bie ndesh me shfrytëzimin e pronës për qëllime familjare”.³⁵ Sa i përket rastit *Marckx* Gjykata Evropiane ka konstatuar se shteti ka pasur obligim pozitiv që të ofrojë sistemin mbrojtës ligjor për fëmijun ilegjitim që ai të integrohet në familjen e tij. Për më tepër në rastin *Airey*³⁶, dështimi i shtetit përbëhej nga mungesa e një mjetei juridik efektiv për mbrojtjen e një anëtari të familjes nga kërcënimi i anëtarit tjetër të familjes. Sidoqoftë, në bazë të legjislacionit të Konventës Evropiane, obligimi pozitiv i shtetit nuk shtrihet vetëm në dhënien e përkrahjes për substancën e jetës familjare përfshirë përkrahjen financiare, përzjerja tjetër në të drejtat e parapa në nenin 8 mund të justifikohet vetëm nëse ekzistojnë masa parandaluese procedurale kundër trajtimit/shërimit arbitrar.

Përveç KEDNj-së, Konventa mbi Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmiut (KDF), Konventa mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Gruas dhe Marrëveshja Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike dhe Liritë Fundamentale, janë direkt të zbatueshme në Kosovë nëpërmjet të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë.³⁷ Gjykata Evropiane ofron udhëzime nëpërmjet të precedentit të saj gjyqësor sa i përket të drejtës për jetë familjare dhe kërkesat procedurale përkitazi me vendimet e autoriteteve të cilat cenojnë të drejtat e parapara me Konventë.

Për qëllime të këtij raporti, dispozitat e rëndësishme të KEDNj-së përfshijnë nenin 8, të drejtën për jetë private dhe familjare dhe nenin 6 mbi të drejtën për gjykim të drejtë dhe publik e cila ndikon në qasjen në procedurat gjyqësore të pavarura dhe të paanshme. Neni 6 është gjithashtu i rëndësishëm sa i përket mundësisë për zbatimin e shqyrtimit gjyqësor të procedurave të IK-së që mundësojnë gjyqet të shqyrtojnë vendimet e autoriteteve vendëse sa i përket qasjes së prindit në fëmijun e tij i cili është marrë në përkujdesje publike. Ku mjet juridik është i mjaftueshëm për të ofruar masa mbrojtëse karshi ushtrimit të pushtetit në mënyrë jo të duhur nga ana e autoriteteve përkatëse.³⁸ Përderisa neni 8 nuk përmban në mënyrë eksplicite kërkesa procedurale, procesi i vendim-marrjes duhet të jetë i drejtë dhe duhet të jetë në mundësi që të respektojë interesat e garantuara me nenin 8.³⁹ Krahas kësaj, Gjykata Evropiane ka deklaruar se ekzistojnë kërkesa që duhet plotësuar sa i përket kohëzgjatjes së procedurave të cilat ndërhyjnë në jetën familjare. Procedurat e gjata kohore mund të konsiderohen si cenim i të drejtave familjare, për shkak se ato mund të tregojnë një mungesë të respektit karshi të drejtës për ribashkimin e familjes.

PJESA 2: RASTET PËR STUDIM DHE ANALIZAT

I. TË DREJTAT E FËMIJËVE

SMPV ka monitoruar 38 raste në të cilat përfshiheshin fëmijët të cilët ishin viktime të krimit. Katërbëshjetë raste kishin të bënin me viktime të dhunës seksuale,⁴⁰ shtatë viktime të trafikimit, tetë fëmijë të braktisur dhe nëntë prej tyre të lënë pas dore sa i përket edukimit/arsimimit.⁴¹ Përderisa shumica e rasteve kishin të bënin me fëmijët e gjinisë femërore, edhe rastet e fëmijëve të gjinisë mashkullore janë monitoruar gjithashtu..

Sipas precedentit gjyqësor të KEDNj, definicioni i termit “jetë familjare” duhet të konsiderohet ai i cili përfshinë çiftin e martuar dhe të pamartuar dhe fëmijët e moshës së mitur. Çiftet e martuara dhe pa fëmijë gjithashtu konsiderohen familje, por edhe prindërit adoptues. Mirëpo mbrojtja sipas KEDNj, nuk kufizohet vetëm në sferën

³⁵ Z dhe E kundër Austrisë (1986)

³⁶ Airey kundër Irlandës (1979)

³⁷ Themeluar sipas rregullores së UNMIK-ut nr 2001/9 mbi Kornizën Kushtetuese të vetëqeverisjes së përkohëshme në Kosovë

³⁸ W kundër MB-ar (1987)

³⁹ Mc Michael kundër MB-ar (1995)

⁴⁰ Dhuna seksuale nënkupton përdhunimin, tentim përdhunimin dhe format tjera të abuzimit seksual.

⁴¹ Lexo rregulloren e UNMIK-ut 2000/51, mbi moshën e obliguar për shkollim në Kosovë.

e familjes së ngushtë, pasi që edhe pas shkurorëzimit do të mbesin lidhjet në mes të prindërve dhe fëmijëve, mirëpo ajo ka ndikim të posaçëm edhe në të drejtat e vizitës së fëmijëve.

Fëmiu i definuar në bazë të LMS-së dhe LMMF-së është një person i moshës nën 18 vjet, përkufizim ky i cili është në pajtim me KMF-në.⁴² Fëmijët e moshës mbi 14 vjet shpeshherë emërtohen si “të mitur”. Fëmijët kanë të drejtë të jetojnë me prindërit e tyre, përpos nëse jetesa ndaras e tyre është në interes të “arsyeshëm” apo interes të përbashkët të fëmiut dhe prindërve.⁴³ Fëmijët e lindur jashtë kurorës kanë të drejta të barabarta sa i përket prindërve dhe familjes.⁴⁴ Në procedurat gjyqësore për fëmijë (duke përjashtuar këtu procedurat kundër personave të moshës nën 18 vjet) apo sa i përket zotësisë juridike të personave, IK-ja është palë në procedurë.⁴⁵ Në procedurat ku ajo nuk është palë, duke përfshirë këtu edhe procedurën penale kundër fëmijëve, ai është i autorizuar të marr pjesë. Ai mund të jep propozime, ofrojë dëshmi, të zbatojë institutin e mbrojtjes ligjore dhe të inicojë procedurë gjyqësore. Nga gjykatat kërkohet të njoftojë IK-në përkitazi me të gjitha procedurat, të sigurojnë pjesëmarrjen e tyre në procedurë dhe t’ju dorëzojnë atyre vendimet që i marrin mbi një çështje.⁴⁶

Meqë, QPS-ja konform obligimeve të tyre për mbrojtje sociale, në përgjithësi i mban përgjegjësitë ligjore të IK-së ashtu siç është paraparë me ligj, ato në të vërtetë funksionojnë si një agjenci shtetërore për mirëqenien e fëmijës. IK-ja në përgjithësi mbikqyrë të drejtat e prindërve për t’u kujdesur për fëmijët e tyre dhe me ligj është i autorizuar të ndërmerr veprime në mbrojtjen e fëmijëve atëherë kur është në dijeni apo kur njoftohet për dështimin e prindërve apo tjerëve me autoritet prindor, që të kujdesen dhe mbikëqyrin fëmion.⁴⁷

IK-ja ka për obligim të kujdeset për fëmijët, sikur ata që janë nën gjithashtu edhe ata mbi moshën e përgjegjësisë penale, e të cilët gjinden në konflikt me ligjin apo prindërit e tyre.⁴⁸ IK-ja vendos për personat të cilët përkohësisht apo në mënyrë të përhershme banojnë brenda jurisdikcionit të QPS-ve gjatë kohës kur shfaqen rrethanat për marrjen e vendimit mbi ushtrimin e kujdesjes.⁴⁹ Nëse personi nën kujdesje ndërron vendin, atëherë ndërron edhe IK-së dhe me atë rast ky i fundit mund të merrë në rishikim disa aspekte të vendimit të parë mbi kujdesjen.⁵⁰ Standardi themelor juridik për vendimet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve është që secili vendim i tillë duhet të merret për “interesin më të mirë për fëmion”, e që është konform standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.⁵¹ Gjykatat dhe IK-ja mbajnë përgjegjësi që për të gjitha rastet që kanë të bëjnë me kujdesjen dhe edukimin e fëmiut, të “hulumtojnë në mënyrë adekuate të gjitha rrethanat ekzistuese të cilat janë të rëndësishme për zhvillimin e duhur psikologjik dhe fizik të fëmiut, dhe të arsimimit, dhe që si bazë para së gjithash të merret parasyshë interesi i fëmiut.”⁵²

Rasti 1

Në korrik të vitit 2002, në komunën e Vushtrrisë – regjioni i Mitrovicës, SMPV ka monitoruar një rast në të cilin bashkëshorti i cili punonte në Gjermani dyshonte se gruaja e tij e mashtronte. Ai besonte se vetëm njëri prej katër fëmijëve ishte i tij dhe e akuzonte gruan e vet se ajo ishte marrë me prostitucion gjatë qëndrimit të tij jashtë

⁴² Neni 15 i LMMF thekson: “mosha madhore arrihet në moshën 18 vjeçare. Me arritjen e moshës madhore apo në rast se personi hyn në martesë para kësaj moshe, personi do të konsiderohet me zotësi veprimi”.

⁴³ Neni 101 i LMMF. Vërejtje: interesi i “arsyeshëm” duhet të kuptohet si “interesi më i mirë” konform standardeve të të drejtës ndërkombëtare në fuqi (KDF-ës)

⁴⁴ Neni 7 i LMMF.

⁴⁵ Neni 4 of the LNCP.

⁴⁶ Neni 11 i LMMF dhe Neni 459 LPP i RFJ.

⁴⁷ Në përgjithësi, ekziston një detyrim për të raportuar të cilin e kanë të gjithë qytetarët sidomos kur duhet të informohet IK-ja “menjëherë pasi që të kuptojnë se ...nëse prindi është në pamundësi të ushtrojë të drejtën e tij prindore, apo nëse fëmion, respektivisht të miturit për arsye të tjera i nevojitet mbrojtje.” Neni 119 (2) i LMMF-së.

⁴⁸ Neni 16 i LMS-së definon “fëmion e lënë pas dore në aspektin edukativ” si një fëmijë i cili më veprimet e tij/saj shkel normat e përgjithshme publike të sjelljes (duke ikur nga shtëpia dhe shkolla, sillet si endacak apo diçka e ngjashme); shkel rregullat e ruajtjes së rendit dhe qetësisë publike; apo shkel dispozitat e ligjit penal.

⁴⁹ Neni 241 i LMMF-së.

⁵⁰ Neni 242 i LMMF-së.

⁵¹ KDF-ve, i obligon shtetet palë nënshkruese që “të marrin të gjitha masat e duhura për të siguruar se fëmijët janë të mbrojtur kundër të gjitha formave të diskriminimit apo ndëshkimit të bazuar në statusin që e kanë”. Më tej, thekson se gjatë të gjitha veprimeve ndaj fëmijëve, të ndërmarra si nga institucionet publike apo private të mirëqenies, gjykatave, autoriteteve administrative apo legjislative, në rend të parë, interesi më i mirë për fëmijën gjithëherë duhet merret parasyshë (neni 3(1) i KDF-ës). Shtetet palë janë të obliguara të ndërmarrin të gjitha masat në rrafshin legjislativ, administrativ dhe rrafshet tjera të rëndësishme për të siguruar mbrojtjen e fëmijëve. Posaçërisht ato duhet të sigurojnë se institucionet, shërbimet dhe entet përgjegjëse për kujdesin ndaj fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre, të jenë në përputhje me standardet e krijuara nga autoritetet kompetente (neni 3(3) KDF-së.

⁵² Neni 116 i LMMF.

vendit. Në vitin 1998, ky çift ishte shkukurëzuar por gruaja refuzonte të largohej nga shtëpia. Bashkëshorti vazhdoi t'a kërcënonte dhe abuzonte ish-bashkëshorten e tij dhe në fund e qëlloi për t'a vrrarë me një armë të dorës dhe në prani të dy fëmijëve, njëri njëvjeçar ndërsa tjeri katërmbëdhjetë. QPS-ja ishte informuar për këtë rast nga ana e OSBE-së. Mirëpo asnjë masë nuk është ndërmarrë për të ofruar ndonjë këshillim për fëmijët. Sipas QPS-së ata nuk kishin nevojë për masa speciale pasi që "gjendja psikologjike e fëmijëve ishte mjaft stabile". Pas intervenimit të OSBE-së, QPS-ja i ka vizituar në mënyrë jo të rregullt këta fëmijë dhe procedura e adoptimit është në zhvillim e sipër. Në këtë rast QPS-ja kishte autoritet që të ushtrojë funksionin e IK-së me qëllim të mbrojtjes së fëmijëve gjatë së cilës ajo kishte dijeni mbi dështimin e prindërve për t'ju ofruar fëmijëve kujdes dhe mbikëqyrje. Mirëpo në këtë rast nuk është marrë plotësisht në konsideratë interesi më i mirë për fëmijun.

Rasti 2

Në Prizren, në komunën e Malishevës, SMPV-ja ka monitoruar dy raste në të cilat QPS-ja kishte shfaqur qasje pasive në dhënien e shërbimeve të mbrojtjes sociale. Rastet kishin të bënin me dy viktimë të dhunimit, njëra gjashtë vjeçare ndërsa tjetra pesëmbëdhjetë. Në rastin e viktimës më të re e cila ishte pranuar në spitalin e Prishtinës, më 24 janar 2002, në gjendje kritike, QPS-ja në fillim u ankua se policia nuk i kishte informuar ata për rastin. Mirëpo pasi që SMPV e kishte furnizuar QPS-në me të dhëna të hollësishme, ajo nuk tregoi ndonjë iniciativë që t'i ndihmojë apo të monitorojë shërimin e fëmijut. Në rastin tjetër të dhunimit, i cili ka ndodhur më 1 mars 2002, QPS-ja ishte informuar nga policia, mirëpo kishte dështuar që të ofrojë shërbime të këshillimit fëmijut duke deklaruar se ju mungon ekspertiza dhe se rasti është mjaft i vështirë, dhe si rezultat i kësaj nuk ishin në gjendje t'i marrin në konsideratë interesat e fëmijut.

Për shkak të mosveprimit nga ana e QPS-së, SMPV-ja kishte ndërhyrë në të gjitha aspektet e mbrojtjes së fëmijut. Kur SMPV-ja arriti të identifikoi një OJQ lokale, që kishte marrë përsipër detyrën e asistimit të të dyja viktimave, QPS-ja nuk e kontaktoi këtë OJQ për të bashkëpunuar. Në një rast drejtori i QPS-së u shpreh para SMPV se ai nuk mund të bënte edhe aq për të ndihmuar në këtë rast, për shkak se ai nuk ishte "punëtor i të drejtave të njeriut" por se ishte "punëtor social", prandaj edhe nuk ishte përgjegjës për t'i shtrirë detyrat e veta përtej përgjegjësisë që dalin nga mbrojtja sociale. Në njërin anë, ky interpretim i detyrave të QPS-së ishte në kundërshtim me rregulloren e UNMIK-it 1999/24,⁵³ e cila deklaron se të gjithë zyrtarët publik janë përgjegjës për respektimin e standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, përfshirë këtu edhe KDF-në. Më tej, QPS-ja nuk kishte ushtruar funksionin e saj të IK-së si duhet për shkak se ajo mundur të iniciojë procedurën gjyqësore në emër të viktimave të mitura dhe të bëjë propozim për mbrojtje ligjore.

Rasti 3

Në Pejë, është vërejtur një qasje pasive në ofrimin e mbrojtjes sociale për një fëmijë të lënë pasdore. Një djalosh dhjetëvjeçar epileptik e ëma e të cilit kishte vdekur, supozohet se është abuzuar nga ana e të atit të tij. QPS-ja ka pranuar se kanë njohuri për rastin që nga nëntori 1999 por se nuk e ka caktuar kujdestarin ligjor, apo nuk ka gjetur zgjidhje të sigurtë për fëmijun.⁵⁴ Mungesa e një veprimi adekuat në këtë rast është në kundërshtim me detyrimet ligjore të QPS-së sipas LMMF-së dhe mundësisht kjo mund të barazohet me shkeljen e nenit 3 të KEDNj-së. Sipas nenit 119 të LMMF-së, IK-ja është i obliguar të ndërmarr masa të nevojshme për mbrojtjen e të drejtave personale të fëmijut. Sanksioni përfundimtar do të ishte nëse QPS-ja do të iniciojë procedurën gjyqësore për largimin e fëmijut nga prindi. SMPV ka mësuar për rastin në maj të vitit 2002 dhe ka intervenuar në QPS e cila mëpastaj kishte caktuar kujdestarin ligjor.

Nëse QPS-ja vëren se prindërit nuk janë duke ofruar kujdesin e duhur për fëmijët e tyre, ata janë përgjegjës që t'i udhëzojnë ata në këshillime adekuate dhe shërbime tjera të nevojshme të sistencës. Mirëpo, në rastet e rënda, QPS-ja mund të vendosë që për së afërmi të monitorojë (përcjellë) kujdesin prindor ndaj fëmijëve.⁵⁵ Atëherë kur QPS-ja përcakton se prindërit paraqesin kërcënim serioz për zhvillimin e fëmijës, QPS-ja mund të mund t'a largojë fëmijën nga prindërit e tij përmes procedurës gjyqësore dhe t'a vënë nën kujdesin e personit tjetër apo organizatës, pa u hequr prindërve të drejtat dhe obligimet tjera e tyre.⁵⁶

⁵³ Rregullorja e UNMIK-it 1999/24, mbi ligjin në fuqi në Kosovë

⁵⁴ Lexo nenin 47 të LMS-le i cili thekson se fëmijët me çrregullime zhvillimore duhet të përkuajen dhe pasojat e çrregullimeve të tyre zhvillimore duhet të mënjanohen.

⁵⁵ Neni 120 i LMMF-së.

⁵⁶ Neni 122 i LMMF-së.

Vendimet lidhur me heqjen e të drejtë prindore për shkak të lënjes serioze pas dore apo keqpërdorimeve gjykata i bjen në procedurën jokontestimore. Të drejtat prindore mund të rivëhen përmes të njëjtës procedurë kur ekzistojnë bazat për revokim/heqje. Prindi, IK-së apo prokurori publik mund të inicojnë procedurën për revokim, dhe në rastet kur IK-së informohet për lënje të tillë pas dore apo keqpërdorim, është i obliguar të inicojë procedurën. Kur IK-së ka njohuri për ekzistimin e rrezikut për keqpërdorim të të drejtës prindore apo lënje pas dore të shkallës së rëndë, ai është i autorizuar të ndërmerrë veprime të nevojshme për mbrojtjen e fëmijës.⁵⁷ Vendimet merren pas dëgjimit me ç'rast prindërit ftohen në dëgjim prë të dhënë deklaratat dhe përfaqësojnë interesat e tyre. Kujdestari i posaçëm mund të emërohet nga gjykata apo organi i kujdestarisë për të përfaqësuar interesin më të mirë të fëmijës gjatë procedurës në rastet kur vetëm njëri prind është i gjallë dhe kujdeset për të, dhe nëse kjo është në interesin më të mirë të fëmijës.⁵⁸

Në mënyrë të ngjajshme, lidhur me zotësinë juridike të personave të sëmurë mentalisht, apo me sëmundje tjera, për të marrë vendime personale, vendimet merren nga gjykata. Kjo përfshinë vendimet për vazhdimin e të drejtës prindore ndaj personit mbi moshën 18 vjeçare kur personi për shkak të sëmundjes mentale, zhvillimit të ngadalshëm, paaftësive fizike apo për shkak të arsyeve tjera konstatohet se është i paaftë të kujdeset për vehtën pjesërisht apo në tërësi edhe pse ai/a jo ka arritur moshën e madhorit.⁵⁹ Në këto raste, emërohet kujdestari i posaçëm për të përfaqësuar interesat e fëmijës.⁶⁰ Nëse personi i tillë duhet t'i besohet institucionit për shërim psikiatrik apo ndonjë kujdesje të llojit tjetër, gjykata duhet të merr vendim për t'a burgosur personin.⁶¹

Shiqar nga këndvështrimi i të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, ekzistojnë tri situata në të cilat kujdesi, përkujdesja dhe kontakti me fëmijët mund të ngrisin çështjet e rregulluar me KEDNj.⁶² Çështjet më të zakonshme që konsiderohen nga e drejta precedendale e KEDNj janë rastet e ndërhyrjes së autoriteteve shtetërore në largimin e fëmijëve prej familjeve të tyre dhe vendimet e ndërlidhura siç janë ato mbi të drejtën e kontaktit, kujt i besohet fëmiju dhe adoptimi. Ligji vendës i cili në mënyrë automatike ia beson fëmijën së ëmës, përgjithësisht është pranuar nga KEDNj.⁶³ Prindit të cilit pas shkurorëzimit nuk i është besuar fëmiju, si rregull, duhet të gëzojë të drejtën e vizitës së fëmijut. Mirëpo, ka edhe rrethana në të cilat këto të drejta mund të kufizohen, së paku përkohësisht. Interesat e prindit dhe fëmijut duhet të balancohen karshi njëri-tjetrit, përderisa interesi i fëmijut duhet të jetë parësor. Nëse të drejtat e vizitës kufizohen seriozisht, apo fare përjshohen, këto çështje e prekin nenin 8(2) të KEDNj mbi të drejtat e mbrojtura prindore. Shtrohet pyetja nëse kjo shkelje është në proporcion me interesin e fëmijës.⁶⁴ Nëse fëmiju është i ndarë nga prindërit dhe është i vendosur nën kujdesin institucional të një personi tjetër, atëherë të dy prindërit kanë të drejtë ta vizitojnë/kontaktojnë fëmijën dhe të njëjtat kritere të shfrytëzuara gjatë shkurorëzimit, shfrytëzohen për të kufizuar të drejtën e vizitës.⁶⁵ Nëse rasti ka të bëjë me fëmijun e rritur, i cili për shkak të hendikepit fizik apo mental është dërguar në institucion, të drejtat e vizitës varen nga rrethanat e secilit rast individual, me ç'rast kontaktet e mëhershme në mes të prindërve dhe fëmijës duhet të merren në konsideratë. Gjatë vendosje mbi kontaktet prindore, duhet të merret në konsideratë edhe dëshira e fëmijës për atë sa ai mund ta shprehë dëshirën.

Atëherë kur autoritetet me dhunë e vendosin fëmijën nën kujesje, duke e dërguar në p.sh, institucion apo familje ushqyese, dhe e ndanë fëmijën nga prindërit e tij, të drejtat e parapar me nenin 8(2) këtu vihen në pyetje. Në një rast të paraqitur në Gjykatën Evropiane, çështja ishte lidhur me dispozitat ligjore të shfrytëzuara për të marrë nën kujdesje tre fëmijë, dhe nëse ato, në masë të konsiderueshme, ishin në pajtim me kërkesat sipas të cilave e drejta e autoriteteve për të ndrëhyrë në jetën familjare është e parashikuar në mënyrë adekuate.⁶⁶ Gjykata Evropiane ka

⁵⁷ Neni 79 i LPJ-së.

⁵⁸ Neni 81 i LPJ-së.

⁵⁹ Neni 129 i LMMF-së.

⁶⁰ Neni 74 i LPJ-së.

⁶¹ Neni 375 i LMMF.

⁶² Gjykata Evropiane ka deklaruar se sa i përket kërkesave për rishikim gjyqësor, gjykat nuk do t'i shqyrtojë meritat e vendimit, por do të koncentrohet në sigurimin se autoritetet nuk kanë vepruar kundër ligjit, në mënyrë të paarsyeshme apo të padrejtë. Kur të merret ndonjë vendim përkitazi me kujdestarinë dhe të drejtat prindore, fushëveprimi i shqyrtimit në mënyrë të ngjashme do të kufizohet.

⁶³ Rasti 13557/88 kundër Danimarkës, D.R. 63 p. 167.

⁶⁴ Lexo p.sh, rastin 9427/78, Hendriks v Holandës, D.R. 36, p.130.

⁶⁵ Rasti 12402/86, Price kundër Mbretërisë së Bashkuar, D.R. 55, p. 224.

⁶⁶ Olsson v Suedisë (1988).

konstatuar se legjislacioni kombëtarë në çështjet e kujdestarisë ishte tepër i përgjithësuar dhe i ka lënë të drejtë të madhe diskrecionale autoriteteve, por megjithatë nuk ka qenë e mundur të krijohen kreiteret specifike për shkak të natyrës së ndërhyrjes nga ana e autoriteteve.

Legjislacioni vendës duhet gjithashtu të respektojë nenin 8(2), i cili thotë se duhet dhënë arsye legjitime nëse dëshirohet të ndërhyhet në jetën familjare të dikujt tjetër. Arsyet e dhëna janë mbrojtja e shëndetit dhe moralit si dhe e të drejtave të personit. Gjatë marrjes së vendimit, autoritetet përkatëse duhet të përcaktojnë se a janë masat e ndërmarra të justifikueshme, të cilat duhet të jenë “relevante dhe të mjaftueshme” për një ndërhyrje të tillë. Në një rast ku tre fëmijë ishin vendosur nëpër familje ushqyese, larg nga njëri tjetri, Gjykata Evropiane vendosi se në këtë rast kishim të bëjmë me shkelje të nenit 8(2) për shkak se distancat e gjata kishin kufizuar më shumë se që ishte e nevojshme të drejtat e prindërve për vizitë.⁶⁷ Autoritetet vendëse janë gjithashtu përgjegjëse për të siguruar që vendimet mbi të drejtat për vizitë të ekzekutohen. Gjykata Evropiane ju ka dhënë autoriteteve vendëse një detyrë aktive për të siguruar ekzekutimin praktik të vendimeve të tilla.⁶⁸ Precedenti gjyqësor i KEDNj-së definon qartë se marrja nën përkujdesje e fëmijëve zakonisht konsiderohet si një masë e përkohshme, përderisa respektimi i të drejtës për jetë familjare ngërthen në veti detyrën e autoriteteve për të siguruar bashkimin e familjes sa më shpejtë që është e mundur.⁶⁹

Rasti 4

Në maj 2002, Seksioni për Mbrojtjen dhe Përkrahjen e Viktimave kuptuan nga policia për një shtëpi të braktisur në Prizren ku katër vajza të moshës prej 12 deri në 16 vjet dhe një djalë i moshës 2 vjet e gjysmë janë duke jetuar pa kujdes të ndonjë personi të moshës madhore. Meshkujt e lagjes e kanë vizituar atë shtëpi disa herë, përderisa njëra nga vajzat madje është dhunuar. Qendra për punë sociale bëri me dije se e kishte të njohur atë rast që nga viti 2000 mirëpo gjithashtu pohuan se ekzistonin probleme të sigurisë (fëmijët vinin nga një familje e njohur për të kaluar kriminale), dhe se ekzistonte një mungesë e resurseve dhe se nuk ekzistonte ndonjë strehim i sigurtë i cili do të ofronte shërbime adekuate për këta fëmijë. Ky rast vë në pah opcionin e QPS-së të rekomandojë vënien e këtyre fëmijëve nën kujdesin e saj për shkak se këta fëmijë ishin të braktisur që së këndejmi ka të bëjë me të drejtat e parapara në bazë të nenit 3 të KEDNj-së. Në bazë të ligjit vendës gjithashtu edhe të atij ndërkombëtar, QPS-ja shumë lehtë ka mundësi të pohojë se janë vënë në shërbim të mbrojtjes së interesave të fëmijëve, veçanërisht në mbrojtje të shëndetit dhe moralit të tyre. QPS-ja kreu detyrat e saj formale të caktimit të kujdesdhënësit, i cili ishte shtëpiak gjatë ditës, ku QPS-ja dështoi që të përcjell punën e kujdesdhënës (neni 214 i LMMF-së). Kujdesdhënësi nuk kishte dijeni mbi detyrimet e tij të parapara me nenin 252 të LMMF-së, të cilat ishin përkujdesi për zhvillimin, shëndetin dhe edukimin e fëmijut. Për shkak të kufizimeve në resurse, QPS-ja vendosi fëmijun dy vjeçar në një shtëpi të sigurtë ku do t'i ofrohej kujdes nga personat e rritur, përderisa katër vajzat vazhdojnë të jetojnë së bashku. Rasti gjithashtu ngrit çështjen e shkeljes së nenit 3 të KEDNj-së për shkak se QPS-ja ka pasur dijeni për këtë braktisje dhe abuzim dhe ka dështuar të merr masa adekuate për mbrojtjen e fëmijëve. Në bazë të nenit 13 të KEDNj-së çdokush të drejtat dhe liritë e të cilit janë shkelur kanë të drejtë për mjet juridik efektiv pranë një autoriteti vendës për shkak të faktit se këto të drejta janë shkelur nga persona të cilët veprojnë në cilësi zyrtare. Për më tepër, Gjykata Evropiane mban një shtet përgjegjës për shkeljen e dispozitës për ndalimin e torturës, trajtimit apo ndëshkimit johuman dhe degradues (neni 3 i KEDNj-së) për shkak se autoritetet për mirëqenien e fëmijut kanë pasur dijeni përkitazi me keqtrajtimin apo lënien pas dore të fëmijut mirepo kanë dështuar që të ndërmarrin hapa efektiv për ti mbrojtur ata.⁷⁰

Rasti 5

Në mars 2002, në Pejë, Seksioni për Mbrojtjen dhe Përkrahjen e Viktimave kishte përcjellur një rast i cili përfshinte 5 fëmijë, nëna e të cilëve kishte vdekur dhe të cilët, siç pohohej, ishin të keqpërdorur nga ana e të atit të tyre. Fëmijët nuk i ndjeknin mësimet në shkollë fare, edhe pse ishin të moshës së detyrueshme për shkollë (9-

⁶⁷ Idem.

⁶⁸ Hokkanen kundër Finlandës (1994).

⁶⁹ Eriksson kundër Suedisë (1989) dhe Eriksen kundër Norvegjisë (1997).

⁷⁰ Rasti Z dhe i të tjerëve kundër Mbretërisë së Bashkuar (2001). E drejta për mjet juridik efektiv në rastet e tilla nënkupton se viktimat e dështimit të autoriteteve për të vepruar duhet të jenë në gjendje të vërtetojnë përgjegjësinë e zyrtarëve apo organeve shtetërore dhe atyre duhet t'ju ofrohet kompenzim duke përfshirë këtu edhe dëmin jo material.

15), gjatë së cilës i ati i tyre ishte dënuar me kusht për shkak të një eksponimi të turpshëm. QPS-ja caktoi një kujdestar ligjor i cili do të kujdesej për fëmijët, mirëpo kujdestari në fjalë e refuzoi atë përgjegjësi duke thënë "se nuk dëshiron të jetë kujdestari i tyre", për shkak se kjo detyrë i është imponuar atij nga ana e QPS-së". QPS-ja në këtë rast nuk arriti t'i plotësoi kërkesat e parapara me nenin 210 të LMMF-së e cila thotë në mënyrë të qartë se kujdestar duhet të jetë personi me aftësi personale dhe shkathtësi të nevojshme për atë punë dhe i cili e jep pëlqimin për t'u bërë kujdestar.

Për më tepër QPS-ja dështoi të veptoi si IK, në pajtim me nenin 5 të Ligjit të Procedurës Jokontestimore, gjatë së cilës ajo mundet të ndërmarrë të gjitha veprimet për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të fëmijëve, apo të ndërmarrë ndonjë veprim në bazë të LMS-së, e cila parasheh mbrojtje sociale për fëmijët pa kujdes prindor.⁷¹ Kjo përfshin sigurimin e arsimimit të detyrueshëm për fëmijë, në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/51.

II. TË DREJTAT E GRUAS

SMPV-ja përcjelli 12 raste të cilat kishin të bënin me kontestet familjare, veçanërisht me sulme fizike kundër gruas të kryera nga ana e bashkëshortëve të tyre. Gjashtë raste rezultuan me shkurorëzim dhe në shumicën prej tyre ishin të përfshirë edhe fëmijët. Një studim mbi dhunën kundër gruas i kryer nga ana e UNIFEM-it gjatë fillimit të vitit 2000 tregoi se 23 % e të anketuarve (të moshës ndërmjet 35 dhe 54 vjeçare) kishin përjetuar dhunë fizike përdorur 18 % prej tyre kishin raportuar se kishin qenë të përdhunuar nga ana e partnerit apo ndonjë anëtar i familjes.⁷² Raporti bënte me dije shkalla e ulët e raportimit të rasteve të dhunës familjare është një dukuri e zakonshme që mbizotëron në shumë vende, e cila reflekton frikë nga dhuna, publiciteti, dëmtimi i reputacionit të gruas dhe mungesa e besimit në institucionet dhe autoritetet e ndryshme. Për më tepër ajo bënte me dije gjithashtu edhe për një lidhje që mund të tërhiqet ndërmjet të ngritjes së shkallës së konfliktit gjatë vitit 1998 dhe ngritjes së shkallës së dhunës familjare.

Më gjerësisht, standardet e zbatueshme për të drejtat e grave ngërthejnë në veti ato të drejta siç janë të parapara edhe me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut (Deklarata Univerzale), KEGjFDKG-në, MNDPC-në dhe KEDNj-në.⁷³ Diskriminimi i femrave është i ndaluar me ligj dhe përfshin të gjitha dallimet, përjashtimet apo kufizimet që i bëhen gruas në baza gjinore e cila ka si efekt apo qëllim të vetëm dobësimin apo zhvleftësimin e pranimit, dhe ushtrimit të këtyre të drejtave nga ana e gruas pa marrë parasysh statusin e saj martesor.⁷⁴ KEGjFDKG-ja parasheh se autoritetet shtetërore kanë përgjegjësi të hartojnë "politika për eliminimin e diskriminimit të gruas" përfshirë këtu edhe miratimin e masave legjislative dhe masave të tjera për ndërmarrjen e veprimeve adekuate në të gjitha fushat, të modifikojë apo anulojë ligjet, rregulloret dhe zakonet dhe praktikatat ekzistuese të cilat diskriminojnë gruan.⁷⁵ Për më tepër, në bazë të nenit 16 të KEGjFDKG-së, shtetet janë përgjegjëse për marrjen e të gjitha veprimeve adekuate për eliminimin e diskriminimit në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me marrëdhëniet familjare dhe martesën dhe të sigurojnë barazinë ndërmjet meshkujve dhe femrave në fushat siç janë shkurorëzimi, fëmijët dhe të drejtat pronësore.

Në bazë të KEDNj-së, shtetet kanë obligim pozitiv që të ndërmarrin veprime për të siguruar të drejtat e njeriut kryesisht në fushën ekonomike, sociale dhe kulturore. Megjithatë, obligimet e tilla janë të shprehura në mënyrë në nenet e kësaj konvente siç është e drejta për jetë dhe ndalimi me ligj i torturës dhe e drejta për gjykim të drejtë. Masa e fundit në bazë të së cilës KEDNj-ja i detyron shtetet që të mbrojnë individët nga shkeljet e të drejtave të tyre të kryera nga persona privat, duhet të caktohet në të ardhmen. Kjo është për shkak të shkallës së gjerë të pushtetit diskrecional i cili u lejohet shteteve për të përcaktuar se çka kërkohet me qëllim që të kemi respektim të të drejtave të njeriut dhe pse konsiderohen këto të drejta si të domosdoshme në kuadër të një

⁷¹ Shih nenet 13 dhe 36 të LMS-së.

⁷² UNIFEM: *Një vlerësim mbi dhunën kundër gruas në Kosovë, 2000, faqe 36-37.*

⁷³ Shih nenet 1 dhe 7 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut; nenet 2 dhe 26 të MNDPC-së; neni 14 i KEDNj-së dhe neni 5 i Protokollit të shtatë të KEDNj-së.

⁷⁴ Shih nenin 1 të KEGjFDKG-së. Marrëveshja ishte miratuar dhe hapur për nënshkrim, ratifikim dhe pranim nëpërmjet të Rezolutës 34/180 të Asemblesë së Përgjithshme të 18 dhjetorit 1979 e cila hyri në fuqi më 3 shtator 1981.

⁷⁵ Shih nenin 2, KEGjFDKG.

shoqërie demokratike, ashtuqë interesat që bijnë në kuadër të sferës private janë shumë vështirë për t'u përcaktuar. Në rastet *Marckx dhe Airey*⁷⁶ shteti ishte i detyruar t'ju jipte individëve një status ligjor, të drejta dhe privilegje me qëllim që të realizohet sigurimi i të drejtave të parapara me këtë Konventë. Në një sërë rastesh, Gjykata Europiane kishte përcaktuar se mund të mos ekzistojë obligimi për të siguruar një kornizë të kënaqshme ligjore, mirëpo gjithashtu edhe obligimi për të mbrojtur të drejtat individuale kundrejt çdo cenimi të tyre nga ana e personave privat.⁷⁷ Në *X dhe Y kundër Holandës*, Gjykata Europiane deklaroi se detyrimi pozitiv "mund të përfshijë miratimin e masave të disajnuara për të siguruar respektimin e jetës private madje edhe në sferën e marrëdhënieve ndërmjet individëve." Rrethanat e veçanta të rastit dhe zbrastësirat ligjore që ekzistonin që na len të dijme se detyrimi që i imponohet shtetit për të penalizuar veprat penale nuk është edhe aq i gjerë. Sidoqoftë, përdhunimi nga ana e bashkëshortit dhe dhuna familjare, të cilat nuk parashihen si vepra penale të definuara me ligj, mund të jenë fusha të mundshme në të cilën mund të argumentohet mjaft për detyrimin pozitiv. Mundësisht, kërkesat gjithashtu mund të parashtrihen edhe në bazë të neneve 3, 8 dhe 13 të KEDNJ-së.

Në bazë të ligjit në fuqi në Kosovë, viktimat femra të dhunës familjare nuk pranojnë mbrojtje speciale,⁷⁸ dhe dhuna familjare dhe përdhunimi martesor nuk janë të definuara me ligj si vepra penale.⁷⁹ Aspektet fizike dhe mentale të abuzimit të cilat ndodhin në kuadër të marrëdhënieve familjare do të ndëshkohet në bazë të ligjit penal dhe përfshijnë vrasjen, lëndimin e rëndë dhe të lehtë trupor dhe përdhunimin martesor.⁸⁰ Neni 18 i legjislacionit mbi rendin dhe qetësinë publike⁸¹ definojnë sulmin fizik i cili ndodh në vende publike, si një vepër e dhunës me të cilën siguria e një personi rrezikohet si rezultat i veprës penale. Me qëllim të ofrimit të mbrojtjes për viktimat e dhunës familjare, policia e UNMIK-ut ka përcaktuar një politikë të saj mbi dhunën familjare sipas të cilës zyrtarët e policisë⁸² janë të obliguar që t'u përgjigjen kontesteve familjare dhe të hetojnë incidentet e pohuara, pavarësisht se veprat penale të cilat pohohen a janë kryer në kuadër të familjes apo në ndonjë kontekst tjetër.⁸³

Rasti 6

Në Prishtinë, një OJQ e cila merrej me një rast të dhunës familjare, e cila kishte të bënte me një shtetase të huaj e cila ishte e martuar me një shqiptar të Kosovës. Shtetasja e huaj në fjalë kishte braktisur bashkësinë bashkëshortore së bashku me dy fëmijët e saj për shkak se kishte qenë e keqtrajtuar me vite nga ana e bashkëshortit të saj. Ajo dëshmoi në gjyq kundër bashkëshortit të saj dhe ishte në rrezik nga hakmarrja që mund të pasonte nga burri i saj. Në prill 2002, kur SMPV-ja arriti të mësoi se bashkëshorti ishte arrestuar dhe paraburgosur nga ana e policisë, ajo gjithashtu u informua nga QPS-ja se gjyqi do të vendos mbi dhënien e kujdestarisë për fëmijët dhe se një vendim i tillë do të merret duke u bazuar në gjendjen financiare të të dy prindëve. QPS-ja deklaroi se për shkak se bashkëshorti e abuzonte gruan e tij në prani të fëmijëve, "nuk do të thotë automatikisht që ai është baba i keq." QPS-ja më vonë informoi OSBE-në se kishin arritur ta pajtonin çiftin dhe ta mbyllin rastin.

Një sërë çështjesh ishin ngritur gjatë këtij rasti. Duke marrë parasysh ligjin vendës, qëndrimi i marrë nga QPS-ja ishte në kundërshtim me nenet 116 dhe 122 të LMMF-së, sipas të cilave QPS-ja është e obliguar që në mënyrë adekuate t'ij hetojë rrethanat të cilat janë të rëndësishme për zhvillimin psikologjik dhe fizik të fëmijut ku si masë e fundit fëmiju mund të largohet nga ana e prindëve të dhunshëm. Fakti se kujdestaria do të bazohet në gjendjen financiare të prindërve edhe më tepër diskriminon gruan dhe gjithashtu do të vëjë në pikëpyetje detyrimet e

⁷⁶ *Marckx kundër Belgjikës* (1979) dhe *Airey kundër Irlandës* (1979).

⁷⁷ *Young, James & Eebster v UK* (1981); *X dhe Y v Netherlands* (1985) ku shteti mbahet i përgjegjshëm për shkak se ligji i tij penal nuk parasheh mjete sipas të cilave mund të ndiqet penalisht sulmi i kryer seksual ndaj gruas së re e hendikepuar metalisht.

⁷⁸ Ligji Penal i KSA të Kosovës (1977); LP i RSFJ-së (LP i RFJ) (1977 dhe 1986); LP i RS-së (1977 dhe 1994), Ligji mbi rendin dhe qetësinë publike (1981) dhe Ligji mbi kundërvajtjet 1979.

⁷⁹ Projekt rregullorja e UNMIK-ut mbi ndalimin e dhunës familjare ka dhënë definimin e "dhunës familjare" por nuk e definojnë si krim vetvetiu. Sa i përket përdhunimit martesë: Lexo rregulloren e UNMIK-ut 2003/1, të shpallur me 6 janar 2003.

⁸⁰ *Ibid.* Lexo nenin 38. Gjithashtu shih nenin 39 të LP të KSA të Kosovës.

⁸¹ Lexo LRQP-ke të KAS të Kosovës në fuqi që nga 10 prilli 1981.

⁸² Lexo politikën e UNMIK-ut mbi dhunën familjare të datës 13 shtator 2000, pjesa 3.1.3 në lidhje me krimet e veçanta në bazë të të cilave mund të ndiqet penalisht dhuna familjare.

⁸³ Lexo politikën e UNMIK-ut mbi dhunën familjare të datës 27 shtator 2001, pjesa 3.0, e cila parasheh bazën ligjore e cila i mundëson policit që të përgjigjet në dhe të hetojë incidentet e dhunës familjare.

³⁵ Shih nenet 343 dhe 345 të LMMF-së

shtetit sipas KEGJFDKG-së, e cila parasheh barazi ndërmjet bashkëshortëve në kuadër të familjes sa i përket çështjeve martesore.

Rasti 7

Në maj 2002, SMPV-ja kishte monitoruar një rast në Pejë në të cilin një femër ishte abuzuar për tetë vite nga bashkëshorti i saj i cili punon si polic. Ajo e la shtëpinë së bashku me dy fëmijët e saj dhe shkoi për të qëndruar në kuadër të një shtëpie të sigurtë për një periudhë të caktuar para se të kthehej në Pejë/Peć. Në një vizitë të QPS-së, gruaja e takoi burrin e saj i cili ishte shkarkuar nga detyra. Ajo u sulmua nga burri i saj në prani të stafit të QPS-së përderisa motra e saj dëshmoi për atë rast. Kur kërkua të dijë nga QPS-ja se cila ishte arsyeja për mungesën e intervenimit në këtë rast, QPS-ja u përgjegi se kjo ishte thjeshtë një çështje e brendshme familjare, dhe se nuk ishte detyrë e tyre për të intervenuar në këtë rast. Përpos përgjegjësive të tyre në fushën e shërbimeve sociale, QPS-të do të duhet të kenë konsideruar se ishin dëshmitar të një veprë penale të sulmit fizik dhe prishjes së rendit dhe qetësisë publike. Qëndrimi i QPS-së reflekton zakonet të cilat mbizotërojnë në Kosovë të cilat e perceptojnë dhunën kundër gruas si një çështje familjare dhe në bazë të kësaj ne thirrëmi në detyrimet e shtetit për të hequr praktikën dhe zakonet e tilla të cilat janë diskriminuese. Mundësisht, rasti ngrit mundësinë e parashtrimit të kërkesës në bazë të nenit 3 të KEDNJ-së.

Në bazë të së drejtës civile vendëse, kurdo që të kemi të bëjmë me kontestet rreth martesës, gjyqi posedon me kompetenca për zgjidhjen e kërkesave për shkurorëzim, në kuadër të së cilës përfshihet edhe procedura për pajtim. Roli i QPS-ve në adresimin e rasteve të dhunës familjare bazohet në detyrimin e tyre për të zgjidhur kontestet familjare nëpërmjet të këshillimit dhe pajtimit. Në bazë të nenit 339 të LMMF-së, IK-ja ka mandat që të zbatojë procedurën e pajtimit duke shfrytëzuar punëtorët social dhe metodat tjera profesionale, sidomos në rastet në të cilat përfshihen fëmijët e mitur. Në rastet tjera, gjyqi zbaton procedurën e pajtimit. Procedura e pajtimit nuk mund të zgjas më shumë se tre muaj dhe nëse bashkëshortët nuk arrijnë pajtim, IK-ja duhet të raportoi mbi zhvillimin e situatës. Në rastet kur gjyqi zbaton procedurën e pajtimit, mbahen seanca të posaçme dëgjuese dhe gjyqi është i obliguar që të bashkëpunojë me IK-në, veçanërisht në rastet me fëmijë të mitur.⁸⁴ SMPV-ja kishte vërejtur në shumë raste shfrytëzimin e procedurës së pajtimit, sidomos në rastet e dhunës familjare ku është shumë e vështirë që të vie deri tek pajtimi p.sh veprat e rënda të dhunës familjare, (shih rastet e studimit 6 dhe 8).

Rasti 8

Në mars 2002, në komunën e Suharekës/Suva në rajonin e Prizrenit, SMPV-ja ka monitoruar një rast në të cilin një grua ishte e lidhur për karrige dhe ishte rrahur për katër orë në fytyrë dhe kokë nga burri i saj dhe atë në prezencë të dy fëmijëve, njëri i moshës 19 muaj dhe tjetri 6 javë. Incidenti i ishte raportuar policisë së bashku me një incident tjetër të mëparshëm⁸⁵ kur gruaja edhe pse ishte në periudhën kur duhej të lindte ishte therrur me thikë duke pësuar lëndime të përhershme në dorë. SMPV-ja kishte bërë hetime rreth rastit dhe kishte gjetur se QPS-ja kishte kufizuar rolin e saj vetëm në shqyrtimin e nevojës për dhënien e përfitimeve sociale dhe në dhënien e ndihmës në pajtimin e çiftit. Përndryshe ajo nuk morri në konsideratë nevojën për dhënien e ndihmës mjekësore, asistencës psikologjike apo përfaqësimin ligjor.⁸⁶ Bashkëshorti kërkoi falje duke theksuar se kishte qenë i dehur kur e kishte kryer sulmin dhe si rezultat i kësaj gruaja tërheqi akuzat.

Një konsideratë e rëndësishme në sigurimin e mbrojtjes për gratë është se stafi i QPS-së i gjinisë femërore është i angazhuar kryesisht në çështje të grave. Për momentin, përqindja e femrave të punësuar në kuadër të QPS-së nuk ishte i ekuilibruar sa duhet, janë gjithsej 160 meshkuj dhe 92 femra. Gjithashtu ka edhe femra të cilat kanë pozita udhëheqëse nëpër QPS anëmbanë Kosovës, edhe pse vetëm 6 femra ushtrojnë funksionin e drejtorit, përderisa kemi 22 meshkuj të cilët kryejnë këto detyra.⁸⁷ SMPV-ja kishte vërejtur se QPS-të anëmbanë Kosovës janë në mungesë të madhe të programeve dhe shërbimeve (përfshirë këtu edhe strehimoret) që do t'u

⁸⁴ Shih nenet 343 dhe 345 të LMMF-së

⁸⁵ Në bazë të nenit 39 të Ligjit Penal të Kosovës, shfrytëzimi i armës me qëllim të shkakimit të lëndimit të lehtë trupor paraqet veprë penale për të cilën shqiptohet dënimi deri në tre vjet burg.

⁸⁶ Neni 34 i LMS-së.

⁸⁷ Shih Shtojcën II.

ofroheshin personave të varur nga alkoholi dhe personave me varësi të tjera të cilat në mënyrë të tërthortë mund të jenë shkaktoare të dhunës familjare.

III. TË DREJTAT E PERSONAVE TË SËMURË MENTALISHT

Të drejtat e personave të sëmurë mentalisht, të janë nën përkujdesje mjekësore apo të atyre që kanë nevojë për mbrojtje speciale, janë të mbrojtura me standarde të Kombeve të Bashkuara siç janë standardet e KB-ve për Mbrojtjen e Personave me Sëmundje Mentale dhe Përmirësimin e Kujdesit Shëndetësor Mental (Parimet e KSHM). Të gjithë personat me paaftësi janë të mbrojtur me Rregullat Standarde mbi Barazinë e Mundësive për të gjithë personat me paaftësi. Puna me personat e sëmurë mentalisht ngërthen në vete një sërë sfidash për shërbimet sociale në Kosovë, ku njëra prej tyre është mungesa e dijenisë se cila nga institucionet në vend ka mandat për t'u marrur me personat me sëmurë mental, kushtet në bazë të të cilave këta persona mbahen në trajtim dhe mbrojtja e cila u ofrohet. Çështjet siç janë paraburgimi i personave të sëmurë mentalisht paraqet një shkëlqje të neneve 3 dhe 5 të KEDNj-së. Paraburgimi sipas ligjit është i lejueshëm vetëm nëse është përcaktuar mëparë se personi në fjalë është i rrezikshëm për sigurinë publike dhe kur një gjë e tillë është në vetë interes të personit në fjalë.

SMPV-ja kishte monitoruar raste të ndryshme të cilat përfshinin personat e sëmurë mentalisht, e cila gjë kishte shkaktoar brenga sidomos sa i përket shkallës së njohurisë që duhet ta ketë QPS-ja mbi atë se cili është roli i saj në këtë fushë dhe njohurisë mbi ligjin në fuqi në Kosovë. Për momentin në Kosovë, DMS-ja menaxhon me punën e inditucioneve të shëndetit mental, siç është Institucioni për Persona të Retarduar në Shtimje dhe Shtëpia e Pleqve në Prishtinë.⁸⁸ Mandati i QPS-ve në aspektin e dhënies së ndihmës personat të sëmurë mentalisht mbetet në suaza të detyrimeve që i ka IK-ja. QPS-ja ka mandat të mbrojë interesat më të mirë të personave të sëmurë mentalisht dhe në bazë të LPJK-së, QPS-të mund të propozojnë heqjen apo kthimin e zotësisë juridike të personit të sëmurë mentalisht.⁸⁹ QPS-të thirren nga gjykata që të paraqesin gjatë seancës kryesore rastin e personit të sëmurë mentalisht dhe në bazë të asaj të rekomandojnë heqjen e zotësisë së tij/saj juridike. QPS-ja ka të drejtë të parashtrojë ankesë të posaçme kundër vendimit të gjyqit.⁹⁰ LPJK-ja⁹¹ gjithashtu parasheh se kur një person i sëmurë mentalisht vendoset në një institucion neuropsikiatrik, pa pëlqimin e tij/saj, institucioni shëndetësor është i detyruar që të informojë IK-në për këtë gjë. IK-ja mban të drejtën për të inicuar procedurën për lirimine personit të sëmurë mentalisht nga institucioni mjekësor.

Në përgjithësi, ligji i tanishëm mbi kujdestarinë (LMMF-ja dhe LPJK-ja) nuk parasheh masa mbrojtëse substantive dhe procedurale siç parashihen edhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Vendimet mbi dhënien e kujdestarisë për momentin janë duke u marrë pa mbajtjen e një seance dëgjuese pranë një autoriteti të pavarur, dhe pa realizimin e të drejtës për avokat mbrojtës i cili do të përfaqësonte të drejtat e klientit, pa ndonjë kërkesë që gjykimet, mendimet dhe dëshirat e personit në fjalë të respektohen në mënyrë ligjore dhe pa përfaqësim nga ndonjë organ i autorizuar dhe pa mbrojtje nga vendimi për caktimin e kujdestarit interesat e të cilit bien ndesh me ato të personit në kujdestari.⁹² Ligji parasheh që QPS-ja duhet të veprojë duke i përfaqësuar interesat më të mirë të personave me paaftësi mentale, e cila praktikë fatkeqësisht shumë pak është zbatuar, e cila ka rezultuar në pasoja serioze, siç potencohet edhe me rastet e studimit 9 dhe 10.

Rasti 9

Më 5 mars 2002 në Prishtinë/Priştina, SMPV-ja monitoroi një rast të një femre (shtetas i huaj) të sëmurë mentalisht, e cila ishte viktimë e trafikimit. Gruaja moldave ishte arrestuar nga policët e SHPK-së për shkak të kalimit të paligjshëm të kufirit dhe ishte akuzuar dhe dënuar me tetë ditë burgim në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan/Lipljan. ShHTTP-ja i cili është organi gjegjës i cili përcakton se a është një person viktimë e trafikimit apo

⁸⁸ Udhëzimi Administrativ i UNMIK-ut 2/2000.

⁸⁹ Shih LPJK-në, nenet 32 dhe 42 si dhe nenet 45-55.

⁹⁰ Shih nenin 39 të LPJK-së.

⁹¹ Shih nenet 45 deri në 55 të LPJK-së.

⁹² Për më shumë informata të hollësishme mbi paraburgimin e paligjshëm të personave me paaftësi mentale shih Raportin e OSBE-së mbi Sistemin e Drejtësisë Penale (shtator 2001- shkurt 2002) dhe Raportin Ndërkombëtar mbi të Drejtat e personave me paaftësi mentale në Kosovë (2002).

jo, nuk ishte informuar për rastin. Një psikiater në Lipjan/Lipljan kishte përcaktuar diagnozën e sëmundjes mentale nga e cila vuan femra në fjalë duke thënë se ajo është “autizmi” dhe “depresioni i rëndë”. Sëmundja mentale nga e cila vuan ajo rezultoi në pamundëinë e saj për të marrë vendime të cilat do të shkonin në dobi të saj. Në qendrën e paraburgimit në Lipjan, ONM-ja në kuadër të mandatit të saj i cili është ofrimi i ndihmës për riatdhesim viktimave të trafikimit, u përpoq që të intervistojë viktimën. Për shkak se ajo ishte duke marrë barna për qetësim, ONM-ja kërkoi që ky marrja e këtyre barnave të ndalet menjëherë ashtu që ajo të ketë mundësi të intervistohet dy ditë më vonë. Pas intervistës, femra u identifikua si viktimë e trafikimit dhe si rezultat i kësaj ajo bëri kërkesë për ndihmë për riatdhesim kur u dërgua në shtëpinë e sigurtë, gjendja e saj shëndetësore u keqësua edhe më tej gjatë së cilës ajo refuzoi të riatdhesohet duke u pajtuar që të qëndroi në atë strehimore vetëm për një periudhë të shkurtër kohore. ONM-ja kontaktoi QPS-në në Prishtinë duke kërkuar ndihmë nga ajo. Mirëpo QPS-ja refuzoi që të marrë përgjegjësinë për rastin për shkak se ata mendonin se nuk kanë përgjegjësi ligjore për t’ju ndihmuar viktimave të trafikimit, apo personave të sëmurë mentalisht, veçanërisht nëse viktimat ishin shtetas të huaj. Sidoqoftë, dispozitat e LMMF-së dhe LPJK-së do të ishin të zbatueshme. Në veçanti, neni 269 i LMMF-së obligon QPS-në të ndërmarr masa për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të të këtij shtetasi të huaj. DMS-ja pranoi se se rasti bie në kuadër të mandatit të tij, mirëpo ai nuk mund të bëjë asgjë për shkak se nuk kanë resurse për të ofruar ndihmë në këtë rast. Pas vendimit të DMS-së, rasti në fjalë iu kthye QPS-së në Prishtinë e cila bëri kërkesë që të jipet një mendim i dytë psikiatrik.

Rasti 10

Që nga 30 janari 2002, SMPV-ja monitoroi një rast të dhunës familjare në Malishevë me pasoja tragjike për shkak se abuzuesi i cili ishte i sëmurë mentalisht ishte vrarë nga i biri i tij pas shumë viteve të dhunës dhe abuzimit që i kishte përjetuar nga i ati i tij.

Rrethanat e rastit ishin të atilla ashtu që shtyen familjen të ndihmë nga QPS-ja dhe si rezultat i kësaj personi i sëmurë u dërgua në Qendrën Klinike Universitare në, Repartin e Neuropsikiatrisë, ku i’u nënshtrua procesit të diagnostifikimit. Ai u konstatua si i sëmurë nga “psikoza e paranojës” dhe si rezultat i kësaj u lirua për në shtëpi. Spitali kishte kërkuar nga familja para lirimit të personit në fjalë që të gjejë dikë i cili do të qëndronte me personin e sëmurë mentalisht si kujdesdhënës. Për shkak se familja nuk mundi të gjejë një person i cili do të ishte kujdesdhënës, spitali u detyrua ta lirojë atë. QPS-ja nuk ishte e përfshirë në komunikimin ndërmjet të spitalit dhe familjes, mirëpo kishin dijeni se personi i sëmurë mentalisht posedonte revole në shtëpinë e tij. Personi i sëmurë mentalisht u bë përsëri i dhunshëm dhe e sulmoi djalin e tij të mitur, i cili duke vepruar në vetëmbrojtje e vrau të atin me një cung. Njëra nga çështjet të cilën e kishte vërejtur SMPV-ja në këtë rast dhe e cila kishte ndikim në ofrimin e ndihmës ishte edhe vështirësia në komunikimin ndërmjet Repartit të Neuropsikiatrisë dhe QPS-së.

IV. VIKTIMAT E TRAFIKIMIT

Trafikimi paraqet një rëndësi nga çështjet më brengosëse sa i përket shkeljes së të drejtave të njeriut në Kosovë. Në bazë të ONM-së, çdo vit, vlerësohet se rreth 200,000 persona, shumica femra dhe vajza të reja, trafikohen nga Evropa Lindore dhe Azia Qendrore. Këto femra trafikohen për në vendet evropiane, përfshirë këtu edhe Kosovën dhe jetojnë nën kushte të barabarta me skllavërinë. Kosova konsiderohet si “pikë destinacioni” për trafikimin, përderisa raportet e kohëve të fundit bëjnë me dije se Kosova është gjithashtu një vend i origjinës. Akterët kryesor që e luftojnë trafikimin janë OSBE-ja, ONM-ja, Shtylla e II-të e UNMIK-ut dhe OJQ-të vendëse dhe ndërkombëtare të cilat janë palë të Procedurave Standarde Operative të cilat definojnë qartë të gjitha hapat që duhet ndërmarrë për identifikimin e viktimave – shtetasve të huaj, dhe ofrimin e ndihmës së drejtpërdrejt atyre.⁹³ DMS-ja, policia e UNMIK-ut dhe OSBE-ja janë duke punuar për momentin në krijimin e një procedure të ngjashme të standardeve operative, në bazë të të cilave do t’u ofrohej ndihmë e drejtpërdrejt viktimave të trafikimit të brendshëm.

Detyrimi i shteteve për të mbrojtur viktimat e trafikimit buron nga neni 6 i KEGJFDKG-së, e cila parasheh që “Shtetet anëtare do të marrin masa adekuate, përfshirë këtu edhe legjislacionin, për të shtypur format e trafimit

⁹³ PSA-ja ka hyrë në fuqi që nga shtatori i vitit 2000 dhe së fundi ishte azhuruar në gusht 2002. DMS-ja, policia e UNMIK-ut dhe OSBE-ja për momentin janë duke punuar së bashku me një OJQ vendëse në drejtim të krijimit të një Procedure Standarde Operative të ngjashme me atë të sipërpërmendur, me të cilën do të parashihet dhënia e ndihmës së drejtpërdrejt për viktimat e trafikimit të brendshëm.

dhe shfrytëzimit të femrave”. Krahas KEGJFDKG-së, Protokollin për të Parandaluar, Shtypur dhe Ndëshkuar Trafikimin me Njerëz, e plotësuar nga Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional⁹⁴ si dokumente ndërkombëtare ligjore me karakter obligativ të cilat ndalojnë trafikimin me njerëz, dhe definojnë një brez të gjerë të përgjegjësive shtetërore nëpërmjet të parandalimit, mbrojtjes, ndihmës dhe ri-integrimit të viktimave të trafikimit. Neni 4 i KEDNj-së ndalon skllavërinë dhe punën e detyruar, sikurse edhe neni 4 i Deklaratës Univerzale, i cili thekson se “asnjë person nuk do të mbahet në skllavëri apo robëri; skllavëria dhe tregtia me skllavëri do të ndalohet me të gjitha format e saj.”

Ligjet vendëse penale dhe civile,⁹⁵ dhe Rregullorja e UNMIK-ut 2001/4 parashohin mjete të posaçme juridike që mund të shfrytëzohen nga viktimat e trafikimit. Në bazë të ligjit të zbatueshëm, shërbimet e mirëqenies sociale me mandat për të vepruar si IK nëpër komunitat e tyre përkatëse, kanë përgjegjësi për të ofruar mbrojtje dhe mbikëqyrje sociale për menaxhimin e rasteve të viktimave të trafikimit, veçanërisht të atyre që kanë të bëjnë me persona e mitur.⁹⁶ Për më tepër, ligji nuk diskriminon as shtetasit e huaj për shkak se neni 269 i LMMF-së thekson se IK-ja është përgjegjës për “t’ju ofruar mbrojtje shtetasve të huaj që e kërkojnë atë.” Nga QPS-të kërkohet që të “ndërmarrin hapa ligjor për të mbrojtur interesat dhe pasurinë e shtetasit të huaj “përderisa nuk të merret hapi adekuat nga shteti shtetas i të cilit është personi në fjalë.”

Rregullorja e UNMIK-ut 2001/4, vazhdon edhe një hap mëtej dhe definton të gjithë elementet e trafikimit duke u bazuar në parimet e zbatueshme për të drejtat e njeriut. Neni 1 i kësaj Rregullore definton trafikimin me njerëz si veprë penale që ndërthet në veti:

rekrutimin, transportimin, transferimin, strehimin, ose pranimin e personave me anë të kërcënimit ose përdorimit të forcës ose me anë të formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, lajthitjes, keqpërdorimit të kompetencave ose të pozitës së dobësisë, ose me anë të dhënies ose të pranimit të pagesave ose të beneficioneve për të arritur pëlqimin e ndonjë personi që ka kontroll mbi një person tjetër, me qëllim të shfrytëzimit.⁹⁷

Neni 1.1 (b) definton qëllimet e shfrytëzimit si qëllime të “shfrytëzimit seksual, të punës a shërbimeve të detyrueshme, të skllavërisë a praktikave të ngjashme me skllavërinë, të robërimit ose të heqjes së organeve”. Në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores, dhënia e pëlqimit nga ana e viktimës për t’u shfrytëzuar është e parëndësishme.

Sa i përket përgjigjes së tyre ndaj dukurisë së trafikimit, QPS-të kanë shprehur shqetësim se nuk pranojnë apo pranojnë fare pak udhëzime nga ana e DMS-së. Shumica e punëtorëve social i deklaruan SMPV-së se nuk kanë dijeni për kornizën e ndihmës dhe përkrahjes sociale të paraparë me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/4. QPS-të edhe mëtej pohojnë se nuk janë të sigurt se cilat janë përgjegjësitë e tyre ligjore ndaj viktimave të trafikimit, veçanërisht nëse ato janë shtetas të huaj. Sa i përket viktimave të trafikimit të brendshëm, u vërejt se policia nuk është e zellshme për të punuar me QPS-të në këto raste. Punëtorët social të QPS-ve janë ankuar se kur policia i merr në pyetje viktimat fëmijë në stacionin policor, ata nuk janë të lejuar të bisedojnë me viktimën dhe si rezultat i kësaj ata janë në pamundësi të vlerësojnë situatën dhe të përcaktojnë nevojat për mbrojtje sociale të fëmijut. Policia mbështet faktin se ata i trajtojnë informatat personale të viktimës si konfidenciale dhe frikohen se shkelja e konfidencialitetit mund të rrezikojë sigurinë e viktimave.

Rasti 11

Prej marsit deri në prill 2002, rasti i vajzës së re 15 vjeçare nga Rumunia ngriti një sërë shqetësimesh serioze mbi shkeljen e të drejtave të njeriut. Vajza në fjalë u identifikua në një lokal të natës, pas bastisjes nga ShHTP-ja si viktimë e trafikimit. Vajza pranoi që të dëshmoi kundër pronarëve të lokalit të cilët e kishin shtyer me forcë

⁹⁴ E miratuar nga Asembleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në Nju Jork, 2000 ku është ende e hapur për nënshkrim nga shtetet anëtare deri në dhjetor 2002.

⁹⁵ Këto ligje parashohin të drejtën për të parashtruar ankesë në bazë të ligjit mbi pronën dhe të drejtën për ndjekje penale apo për iniciimin e procedurave ligjore.

⁹⁶ Shih LMMF-në, rolin dhe përgjegjësitë e IK-së.

⁹⁷ Shih Rregulloren e UNMIK-ut 2001/4, mbi Ndalimin e Trafikimit me Njerëz në Kosovë.

vajzën që të merret me prostitucion dhe e kishin abuzuar atë në mënyrë fizike. Në atë moment të dyshimit ende nuk ishin paraburgosur dhe si rezultat i kësaj jeta e viktimës ishte në rrezik. Gjyqi nuk urdhëroi kurrfarë masash mbrojtëse për të.⁹⁸ Vajza e refuzoi ndihmën dhe tha se nuk dëshiron të riadhesohet në vendin e saj të origjinës.⁹⁹ Nga QPS-ja, si një institucion i kujdestarisë për të mitur u kërkua që të veprojë urgjentisht me qëllim të gjetjes së një zgjidhje të sigurtë për fëmijun.¹⁰⁰ Nga QPS-ja gjithashtu u kërkua që të caktoi një kujdestar ligjor për të, sa më shpejtë që ishte e mundur¹⁰¹, gjatë së cilës kujdestari do të vepronte për të mbrojtur “interesat e fëmijut”.¹⁰²

Sidoqoftë, gjatë dy muajve që pasuan mëtej, QPS-ja kishte treguar një qasje pasive në gjetjen e zgjidhjes për këtë rast. Ata nuk morrën parasysh faktin se sa i rrezikshëm ishte vendimi i marrë nga vajza për të dëshmuar kundër të dyshimëve pa pasur arranzhime të sigurisë për të, dhe nuk kishte ndonjë intervenim të shpejtë nga ana e QPS-së për të siguruar viktimën. QPS-ja mbështet faktin se policia nuk i informoi ata për adresën e saktë të fëmijut, e cila gjë ngadalësoi procedurën e caktimit të kujdestarit ligjor nga ana e QPS-së. Dy muaj më vonë, QPS-ja në Ferizaj ende ishte e zhytur në huti sa i përket rolit të saj mbi luftimin e trafikimit dhe ofrimin e ndihmës së drejtpërdrejt viktimës.¹⁰³

Rasti 12

Në Mitrovicë/Mitrovica më 6 qershor 2002, rasti i një vajze 16 vjeçare tërhoqi vëmendjen e SMPV-së. Vajza ishte martuar me vendim të të atit të saj në bazë të zakoneve vendëse që në moshën 14 vjeçare, e cila gjë ishte në kundërshtim me nenin 13 të LMMF-së e cila parasheh se moshja për martesë është 16. Bashkëshorti i saj ishte pronar i një lokali të natës i cili e abuzonte atë fizikisht dhe e detyronte me forcë që të përfshihej në prostitucion. Ai ua shiti bashkëshorten e tij tre burrave për t’ju shërbyer atyre seksualisht. Këta tre vëllezër e pruan vajzën 16 vjeçare në Prishtinë ku edhe e abuzuan seksualisht, duke e detyruar që të ketë seks me ta dhe me meshkuj tjerë. Pasi që u burgosën vëllezërit në fjalë, vajza e cila mëpastaj u braktis nga ana e familjes së saj, u detyrua të kthehet në prostitucion, mirëpo kësaj here vullnetarisht. QPS-ja, në komunën ku banon vajza, kishte njohuri për rastin në fjalë, mirëpo nuk ndër morri kurrfarë masash për t’i ndihmuar këtë fëmijë. Ky mosveprim i cili është në kundërshtim me nenin 14 të LMF-së, i cili parasheh që QPS-të duhet të ofrojnë mbrotje sociale të gjithë fëmijëve të lënë pas dore. Për më tepër, po i njëjti ligj, neni 16 parasheh se IK-ja ka për detyrë që t’i mbrojë ata të cilët prishin normat publike dhe shkelin rendin dhe qetësinë publike (p.sh ato femra që angazhohen në prostitucion).

SHTOJCA I

LIGJET E ZBATUESHME TË IDENTIFIKUARA NË FUSHËN E SHËRBIMEVE SOCIALE

- (1) Ligji mbi Mbrojtjen Sociale i vitit 1976 (Gazeta Zyrtare 18/76)
- (2) Ligji mbi Martesën dhe Marrëdhëniet Familjare i vitit 1984 (Gazeta Zyrtare 10/84) (me të cilën janë ndryshuar disa ligje të tjera, përveç tjerash edhe Ligji mbi Kujdestarinë (Gazeta Zyrtare 30/76))
- (3) Ligji mbi Bashkësitë Vetëqeverisëse të Mbrojtjes Sociale i vitit 1974 (Gazeta Zyrtare 35/74)
- (4) Ligji i Procedurës mbi Administratën e Përgjithshme i vitit 1986 (Gazeta Zyrtare 47/86)
- (5) Ligji mbi Kontestet Administrative i vitit 1977 (Gazeta Zyrtare 4/77)
- (6) Ligji mbi Procedurën Jokontestimore (Gazeta Zyrtare 24/86)

⁹⁸ Shih Rregulloren e UNMIK-ut 2001/20, mbi Mbrojtjen e Palëve të Dëmtuara dhe Dëshmitarëve në Procedurat Penale. Gjithashtu, neni 5 i Rregullores së UNMIK-ut 2001/4: “Masat adekuate duhet të ndër mirren me qëllim të mbrojtjes së dëshmitarëve gjatë procedurës hetimore apo procesit gjyqësor.” Për shembull masat për mbrojtjen e dëshmitarëve mund të përfshijnë edhe vëzhgimin policor të lëvizjeve dhe strehimit të viktimave, si dhe ofrimi i transportit të sigurtë nga vendi ku janë të strehuara deri në gjyq dhe anasjelltas.

⁹⁹ ONM-ja, OSBE-ja dhe ShHTP-ja janë pajtuar që t’u ofrojnë ndihmë viktimave të trafikimit. Sidoqoftë, vetëm viktimat të cilat pajtohen që të marrin ndihmë do të ndihmohen.

¹⁰⁰ Sipas nenit 36 të LMS-së, “mbrojtja sociale do t’i jipet, në mënyrë zyrtare, personit i cili është në gjendje të nevojshme sociale edhe pa pëlqimin e tij/saj apo edhe pa pëlqimin e përfaqësuesit të tij/saj, kur kjo është në interes të personit dhe komunitetit social apo kur ekziston interesi i palës së tretë.”

¹⁰¹ Në procedurat gjyqësore të cilat kanë të bëjnë me fëmijë apo procedurat ligjore mbi dhënien e zotësisë juridike një personi për të vepruar në emër të një personi tjetër, QPS-ja mund të parashtrijë propozime pranë gjyqit, të ofrojë dëshmi, zbatojë mbrojtjen ligjore dhe të angazhojë mbrojtësin dhe të iniciojë procedurat gjyqësore.

¹⁰² Shih nenin 3 të KDF-së.

¹⁰³ Në një mbledhje mbi menaxhimin e rasteve të ftuar nga OSBE-ja së bashku me QPS-në, ShHTP-në dhe ONM-në, udhëhëqsi i ekipit të QPS-së shprehi mendimin e tij se prostitucioni është një dukuri e re në Kosovë. Ai tha se kjo ka shkaktuar shumë vështirësi në kuptimin se si duhet adresuar ky problem.

- (7) Ligji mbi Procedurën Kontestimore (Gazeta Zyrtare 69/82)
- (8) Ligji i Procedurës Penale i RFJ-së (Gazeta Zyrtare 26/86 teksti i reviduar)
- (9) Ligji Penal i Kosovës (Gazeta Zyrtare 25/77)
- (10) Ligji mbi Sanksionet Penale (Gazeta Zyrtare 50/84).

SHTOJCA II

Rajoni/Gjith sejt¹⁰⁴	Prishtinë/ Pristina		Mitrovice/ Mitrovica¹⁰⁵		Gjilan/ Gnjilane¹⁰⁶		Prizren		Peja/Peć	
<i>Femra</i>	33		11		8		10		30	
<i>Meshkuj</i>	60		17		15		30		38	
<i>Punëtorë social</i>	F 2 7	M 46	F 10	M 10	F 6	M 7	F 9	M 21	F 26	M 29
<i>Drejtor</i>	F 1	M 6	F 0	M 4	F 0	M 3	F 0	M 5	F 1	M 4
<i>Udhëheqës të ekipit</i>	F 5	M 8	F 1	M 3	F 2	M 5	F 1	M 4	F 3	M 5

¹⁰⁴ Këto shënime janë përpiluar nga QPS-të dhe i janë dorëzuar zyreve rajonale të SMPV-së.

¹⁰⁵ Vërejtje: Shënimet për rajonin e Mitrovicës/Mitrovica nuk përfshijnë QPS-të që veprojnë në komunat e Zubin Potokut dhe të Leposaviqit.

¹⁰⁶ Informatat përkitazi me Gjilanin nuk përfshijnë Kaçanikun dhe Vitinë.